



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel:038/20043814

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY
ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 30-të e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **29.09.2020 (e Martë)**, në sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 15. Eliot Kukiqi, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 16. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 3. Besa Ferati, LDK; | 17. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 4. Naim Behlulaj, LDK; | 18. Labinot Aliaj, PDK; |
| 5. Njomza Demaj, LDK; | 19. Arben Kabashi, PDK; |
| 6. Haki Podrimaj, LDK; | 20. Ajshe Metaj, PDK; |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK; | 21. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 8. Riza Dreshaj, LDK; | 22. Agron Avdijaj, VV; |
| 9. Ruzhdi Metaj, LDK; | 23. Lavdije Bujupaj, VV; |
| 10. Valbona Demaj, LDK; | 24. Arif Elshani, IQ; |
| 11. Edona Lubeniqi, LDK; | 25. Radoš Repanović, SL |
| 12. Naim Imeraj, AAK; | 26. Radenko Belošević, RB dhe |
| 13. Nexhmedin Balaj, AAK; | 27. Slaviša Maliković, SM. |
| 14. Misin Berisha, AAK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në të ishin të pranishëm Kryetari Haki Rugova, drejtorë të drejtorive të komunës, përfaqësues të mediave, zyrtarë të tjerë administrativ (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe gjendet në Youtube bashkëngjitur keni linkun (<https://www.youtube.com/watch?v=IwgbrpnBK5s>)

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj. Kryesuesi përshëndeti të pranishmit, hapi punimet për mbledhjen e 30-të të rregullt, të Legjislacionit të VI-të dhe për këtë mbledhje propozoi rendin e ditës.

Rendi i ditës

1. Konstatimi i prezencës së anëtareve të Kuvendit,
2. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara ,
4. Shqyrtimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, dhe njoftimi me Planin e veprimit për mënjanimin e të gjeturave,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020-2021,
6. Shqyrtimi i Projekt-Buxhetit të komunës për periudhën 2021-2023,
7. Marrja e vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për vitin shkollor,
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi, lidhur me pikat e rendit të ditës, pyes anëtarët e Kuvendit a ka dikush diçka lidhur me këtë rend dite?

Është lajmëruar Arben Kabashi dhe Labinot Alijaj.

Arben Kabashi, përshëndet të pranishmit! Bazuar në komisionin e punës së Kuvendit z.Kryesues kisha pasur dëshirë me marrë një përgjigje ku ju e dini se komisioni ka qenë funksional, pastaj ne e kemi pas bërë edhe një projekt propozim të planit të punës të Kuvendit për vitin kalendarik pra për këtë vit, kështu që nuk ju kemi përmbajtur edhe po me duket që e ka humb atë efektin pse ekziston komisioni i punës së Kuvendit, ku shumë çështje kanë pasur me u diskutuar në këtë vit kalendarik, pothuajse asnjë pikë nuk është fut si rend dite, po ashtu kërkoj për mbledhjen e ardhshme raportim të komisioneve konsultative të cilat janë marrë me vendim të Kuvendit që nuk e dimë mbarëvajtjen e tyre apo punët e tyre këtë vit, kur e dimë sigurt që një herë në vit d.m.th. brenda vitit i bie t'i raportojë Kuvendit për shkak se janë zgjedhur nga Kuvendi, por nuk e kemi një raportim të tillë ende për mbarëvajtjen e punës së tyre. Edhe e treta është, kur të vijmë te pika e fundit e rendit të ditës 'pyetje , kisha kërkuar nga ekzekutivi kryesisht nga drejtorët që të jenë prezentë, për shkak se nëse e bën një pyetje një anëtarë i Kuvendit, atëherë po duhet me prit një muaj për me marrë një përgjigje për shkak se ato pyetje adresohen direkt

prej qytetarëve, atëherë ne edhe mundemi me marrë përgjigje direkt prej kësaj seance. Faleminderit!

Labinot Aliaj, përshëndet të pranishmit! Unë sot kam prit që si pikë e rendit të ditës të jetë raporti i transparencës nga ministria e Administratës, ku komuna jonë radhitet pak mbi mesatare, ose thënë ndryshe diku e 22-ta apo 23-ta me radhë, e ku si shqetësim kryesor i imi është pika ku thotë që, Kuvendi transmetimet e mbledhjeve të Kuvendit komunal të cilat nuk po ndodhin live për vitin 2019 d.m.th jemi rendit e 33-ta si Komunë, ky është një shqetësim për arsye se mediumet të cilat po e bëjnë xhirimin e mbledhjeve, kur po i transmetojnë pastaj, e nuk po janë live ose po i shkurtojnë çka po donë, po nxjerrin çka ata po donë vet dhe jo çka po flitet këtu, kjo ka ndodhë hiç ma larg se mbledhjen e kaluar, kështu që unë kam pritur të paktën nga anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, që do ta sjellin këtë pikë si pikë të rendit të ditës për diskutim, mirëpo nuk ka ndodhë, është shqetësuese se pse po kalohet kjo d.m.th a është raporti nga Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal për performancën e komunes tonë.

Kryesuesi, faleminderit Labinot!

Dikush tjetër nuk është lajmëruar, urdhëro Naim.

Naim Imeraj, Përshëndet të pranishmit! Desha me u lidh me rendin e ditës pastaj merremi me këto çështjet tjera. Pika e gjashtë e rendit të ditës thotë; Shqyrtimi i Projekt-Buxhetit... Shqyrtimi dhe miratimi? A jemi ne fazën përfundimtare të miratimit të buxhetit?

Kryesuesi, po shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Buxhetit për vitin 2021-2023.

I nderuari Arben Kabashi, lidhur me pikat e rendit të ditës, të cilat kanë qenë të parapara në planin e punës të Kuvendit komunal është plan i punës së Kuvendit komunal i miratuar këtu. Është e vërtetë që kemi disa pika të cilat nuk i kemi kapërcyer ende, por ato të cilat parashihen që janë obligative me normat ligjore dhe aktet normative janë në rregull deri me tani. Edhe ato do t'i shikojmë gjatë kësaj periudhe kohore, por pak e din edhe gjendja në të cilën jemi na ka penguar pak për realizimin e disa prej tyre. Lidhur me pyetjet, ne e kemi pikë të rendit të ditës 'pyetjet, dhe unë nuk e di që ka pasur pyetje të cilat është dashtë me prit një muaj përgjigjen, shumica e këtyre pyetjeve janë kryer automatikisht këtu nga anëtarët e Kuvendit, shumicën e rasteve, nuk thamë që nuk ka, por edhe për ato keni marrë përgjigje si anëtarë të Kuvendit.

Lidhur me raportin e transparencës Labinot, çdoherë raportin e transparencës e kemi sjell në Kuvend të Komunës, edhe do të jetë prapë edhe këtë vit, por që mos të ngarkohet një takim me tepër pika duke i pasur parasysh që i kemi disa pika më voluminoze në këtë takim edhe nuk e kemi sjell, raporti është, takimin e ardhshëm do ta keni, se e kemi sjell gjithmonë raportin e transparencës.

Dikush tjetër a e dëshiron fjalën?

Kryetari, e 33-ta? 33 komuna a sa janë?

Labinot Aliaj, nëse hyn e kërkon aty e sheh që është e 33-ta.

Kryesuesi, a ka dikush diçka lidhur me rendin e ditës? Kryetar, dikush nga drejtorët atje diçka po kërkon?

Kryetari, unë mendoj që e ke pak gabim Kryesues, raportet që i bëjnë institucionet tjera nuk diskutohen në Kuvend. Të njoftuar janë, pse duhet? Raportin e Auditimit e keni sot, jemi të obliguar me ligj që me e qit, raportet që i bëjnë ndërkombëtarët janë publike janë transparente, ne në këtë rast veç mund të merremi me rekomandimet, vërejtjet që mund të merren aty e jo me diskutuar. Edhe një gjë po u a them shumë qartë krejt dallavere i ke ne atë raport, po ta garantoj këtu, bile sot kam takim me Kryeministrin edhe me zëvendës Kryeministrin, kryetarët e komunave, kemi takim pikerisht për këtë çështje. Aty janë bërë politika edhe u krye puna. Kur dilnim të parët nëpër Kuvende në krejt Kosovën, askush nuk kërkonte me e diskutuar në Kuvend.

Kryesuesi, nuk kemi nevojë për replikë këtu, nuk ke çka, nuk ta përmendi emrin askush.

Labinot Aliaj, jo e përmendi, në momentin që thotë a janë 36 komuna, kjo është tabela që ka dalë te raporti aty d.m.th renditja e Istogut në raport me 36 komuna jemi të 33-tit.

Kryesuesi, e çka me bë tash?

Labinot Aliaj, po mirë në rregull ,po mos të thuhet që a janë 33 komuna a nuk janë. Duhet me e përcjell raportin.

Kryetari, 80% janë vërejtje në punën e Kuvendit, në punën e juaj, janë në punën e Kuvendit, jo në punën e ekzekutivit. Lexo saktësisht.

Kryesuesi, Agron urdhëro a deshe diçka?

Agron Avdijaj, desha lidhur me atë që nuk është nevoja me raportuar ose me u prezantuar raporte të tilla. Kur po ka elemente pozitive po prezantohen të gjithë, tash ne si opozitë p.sh ose si asambleistë kemi të drejtë me kërkuar që me u prezantuar edhe kur kanë elemente negative raportet e tilla të institucioneve. Edhe ju si institucionalistë kryetar , unë besoj se ju i besoni raporteve që vijnë, po çuditë pse tash nuk po i besoni këtyre raporteve?

Kryetari, nuk ju besoj se dëgjo, qe po të tregojë Agron, i kemi dërguar vërejtje, na kanë dhënë afatin kohor që me jap vërejtje të argumentuara, sigurisht që të gjitha vërejtjet kanë qenë të argumentuara. D.m.th ka qenë një seancë publike, ka qenë një informacion, kur rendin e ditës faktikisht e keni marrë dhe është raportuar, ata kanë marrë informacione aty ka qenë i gjithë problemi, ja kemi dërguar argumentin me data e me fakte nuk e kanë pranuar asnjë. Edhe qëllimisht nuk e kanë pranuar këtu është problemi, aty është defekti asgjë tjetër nuk ka pasur aty.

Kryesuesi, drejtori i drejtoratit të zhvillimit ekonomik po më doket që ka ndonjë propozim lidhur me rendin e ditës e ka një vërejtje të shtoj një pikë të rendit të ditës, urdhëro drejtor propozoje.

Lulzim Blakaj, përshëndet të gjithë të pranishmit! Po propozojë që si pikë e rendit të ditës të shtohet Riallokimi dhe Ridestinimi i mjeteve të mbetura për një projekt të ri kapital dhe mbushja e një projekti ekzistues.

vazhdon me prezantimin e propozimit.

Kryesuesi, drejtor faleminderit!

Edhe diçka formulimi i pikës së rendit të ditës që po propozon, Riallokimi i mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit e morët këtë shkresë dhe e dëgjuat drejtorin e drejtoratit, a pajtoheni që të jetë pikë e rendit të ditës shtesë kjo pikë që u propozua, kush është për?

Kuvendi unanim miraton këtë pikë shtesë të rendit të ditës.

Kryesuesi, pyes anëtarët e Kuvendit kush është që të miratohet ky rend i ditës me këtë pikë shtesë që e propozoi drejtori i zhvillimit ekonomik, kush është për që të miratohet ky rendi i ditës?

Kuvendi unanim miraton rendin e ditës për takimin e sotëm.

Shqyrtimi i pikës 1

Kryesuesi, njoftoi se në mbledhje mungojnë 2 anëtare Ajshe Metaj, dhe Lavdiye Bujupi (të cilat na janë bashkëngjitur gjatë mbledhjes).

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi, Arsyetimi i mungesave, nuk ka ndonjë lajmërim.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi, aprovimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara, ka dikush ndonjë vërejtje për procesverbalet nga anëtarët e Kuvendit? A dëshiron dikush me e marrë fjalën? Jo. Atëherë kush është që të miratohen procesverbalet nga mbledhjet e kaluara? Kush është për?

Konstatohet se Kuvendi unanim miratoi procesverbalet nga mbledhjet e fundit, të mbajtura me datë , 21.07.2020. 30.07.2020 dhe 27.08.2020.

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi, materialin për këtë pikë të rendit të ditës e keni pasur, ashtu si kemi biseduar me Kryetarin një raportim për këtë pikë do ta ketë drejtori i drejtoratit për Buxhet edhe Kryetari nëse dëshiron fillimisht le të urdhëron!.

Kryetari, unë nuk kam se çka të flas raportin e keni të gjithë, tash po i bie ajo që raporti është dalë shumë i mirë, nuk ka dalë asnjëherë më mirë, kështu që nuk po flas hiç. Mos të dalë në ato pozicione që kur po është mirë po flas e kur po është keq po kundërshtojë, Labinot a po kupton se çka po dua të them, e keni para vetes, është i pamodifikuar që është faktikisht standardi më i lartë para atij të pakualifikuar, që ë nuk e di ka ndonjë organizatë buxhetore që e ka arritur për këtë vit po mendoj. Unë jam i kënaqur me punën që ka ndodhur vitin e kaluar, natyrisht që ka edhe vërejtje të cilat janë në rekomandimet e këtij vlerësimi që mundet me u prezantuar.

Kryesuesi, urdhëro drejtor! Hysni Maxharraj e ka fjalën.

Hysni Maxharraj, përshëndet të gjithë të pranishmit! Prezanton: Shqyrtimin e raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, dhe njofton me Planin e veprimtimit për mënjanimin e të gjeturave.

Arben Kabashi, drejtor më fal që po të ndërhyj po ti je veç duke e cituar raportin, na lejo pak të diskutojmë.

Hysni Maxharraj, edhe me shumë jam duke folur se çka ka këtu.

Kryesuesi, drejtori është duke e prezantuar, ne po e dëgjojmë, kur kemi diçka pastaj diskutojmë.

Hysni Maxharraj, unë jam duke e prezantuar sepse këtu i kemi edhe mediat, edhe për hir të qytetarëve që të dëgjojnë edhe qytetarët e Komunës së Istogut , një prezantim total, një punë që e ka bërë ekzekutivi, pra nëse ju jeni dakord unë mund ta lë.

Kryesuesi, vazhdo drejtor, besojë që e kanë pasur materialin edhe e kanë shikuar edhe këta pak, mundesh me e shpejtuar pak.

Drejtori, Hysni Maxharraj vazhdon me prezantimin.

Radoš Repanović, dhe Radenko Belošević lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi, të nderuar anëtarë të Kuvendit, a e dëshiron dikush fjalën?
Agron Avdijaj, Arben Kabashi dhe Arif Elshani janë lajmëruar.

Agron Avdijaj, përshëndet të gjithë të pranishmit!

Ne e dëgjuam me vëmendje prezantimin e drejtorit lidhur me Raportin e Auditorit, po ashtu është e vërtetë që ka dalë pak më mirë se vitin e kaluar, mirëpo meqenëse detyra e drejtorit është me i vënë më shumë në theks përparësitë e raportit detyra jonë si asambleistë është me u marrë pak edhe me disa vërejtje dhe sugjerime, që po ashtu Raporti i Auditorit i ka dhënë. Pas analizimit me kujdes të raportit, përgatitur nga Zyra e Auditorit, si institucion i pavarur dhe kredibil sa i përket rishikimit dhe menaxhimit financiar të institucionit buxhetor ku përfshihet edhe Komuna e Istogut, janë vërejtur disa lëshime, që për mua si asambleistë edhe janë serioze. Janë serioze edhe për faktin që janë të përsëritura shumë herë, edhe kjo dihet që përsëritja e gabimeve pastaj të lë në dyshime që nëse nuk ndërmerret diçka për përmirësimin e tyre, ose bëhen qëllimisht d.m.th me qëllim të kamuflimit apo keqpërdorimeve tjera më të mëdha, ose bëhen nga neglizhenca dhe mungesa e monitorimit të hierarkisë të funksionimit të institucioneve publike, ose edhe bëhet nga mungesa e kompetencës, cila do qoftë prej këtyre d.m.th gabimet janë njerëzore siç ju thashë, mirëpo kur gabimi i njëjtë përsëritet atëherë hyn në njërin prej këtyre kategorive ose në të 3-ja bashkë. Prandaj si Komunë si ekzekutiv, duhet që të merret më seriozisht me trajtimin e sugjerimeve dhe rekomandimeve të Auditorit. Po ashtu Auditori kur te

bën Auditimin e lëndëve ai nuk i merr krejt projektet me i audituar, edhe nëse 100 projekte të realizuara i ka marrë dhjetë prej tyre, edhe në dhjetë prej tyre i ka gjetur tri keqpërdorime, tash nuk është se janë gjetur veç tri ose veç një siç tha drejtori në kuptimin e ofertave ekonomikisht më të favorshme, se unë në raport i kam parë dy që janë, por unë dyshojë që mund të ketë edhe më shumë, për faktin se Auditori nuk i ka inspektuar të gjitha lëndët, por ai e merr një mostër të caktuar e mbi atë mostër nëse dy në dhjetë atëherë përqindja e këtyre lëshimeve është më e madhe se çka është prezantuar edhe në raport. Unë në fakt tash çuditë pak edhe me raportin përderisa është shqetësimi i njëjtë si e pati Kryetari më herët për raportin e përfundimit që tha nuk i besojë, tash te një pikë raporti konstaton që nga rekomandimet e viteve paraprake që kanë qenë 18 (tetëmbëdhjetë) sish vetëm 6 (gjashtë) janë realizuar, 8 (tetë) nuk janë prekur hiç tash është e çuditshme nëse ti ka dhënë 18 (tetëmbëdhjetë) rekomandime 6 (gjashtë) janë realizuar, 8 (tetë) nuk janë prekur hiç ,me disa ke filluar me bërë diçka d.m.th kjo është pak shqetësuese për mua, prandaj unë nuk po dua me hy tash me i përsërit shumë i përmendi drejtori disa tjera që ndoshta edhe nuk i ka përmend mirëpo konsiderojë që Raportin e Auditorit duhet me e marrë më seriozisht. E këtë e konstatojmë edhe ne si asambleistë kur na vijnë materialet këtu në Komunë shpesh kemi paqartësi, edhe në lista të projekteve edhe këto shpesh duhet me humb orë të tëra për me e kuptuar një diçka ose e gjej diku shkruhet me buxhet ndryshe d.m.th po na vë pak në siklet dhe në pamundësi që ne si asambleistë pastaj me e përfunduar punën tonë siç duhet edhe me i dhënë vërejtjet tona më përmbajtjesore. Faleminderit!

Kryesuesi, faleminderit Agron! Fjalën e ka kërkuar Arben Kabashi.

Arben Kabashi, pothuajse vërejtjet janë të njëjta po unë i kam vetëm tri çështje rreth Raportit të Auditimit. E para : se këto raportet e Auditimit më shumë janë bërë sikur të mundshme për Komunën tonë, pas që kur flasim për raport të Auditimit ende vazhdojmë me atë rregullin që i bie 'prit e përcjell'. Pasi që zbatimi i rekomandimit të drejtorit besojë që ende është sfidë për Komunën tonë. P.sh 18 rekomandime që i përmendi edhe kolegu të dhëna nga Auditori i kaluar 6 prej tyre janë zbatuar, 1 ishte në proces, 3 janë mbyllur ndërsa 8 nuk janë adresuar fare. Nuk e kam të qartë se çka është duke ndodhur me raportin e Planit të Veprimit që vazhdimisht dërgohet te rregullatori i Auditimit. Çështja e dytë është se nga Raporti i Auditimit del që në 2019 Komuna ka shpenzuar 68 % të buxhetit final, ose që i bie 11 milion e 298 mijë e 92 euro, me ulje prej përqindjes i bie 3 % krahasuar me vitin paraprak pra 2018. Besoj që nuk është e mundshme me e ditë arsyen e mos menaxhimit adekuat të mjeteve, nëse arsye nuk është afrimi asaj kohe i zgjedhjeve lokale, besoj mundet me qenë ky edhe si pretekst. Dhe çështja e tretë që me ka preokupuar është tek shfrytëzimi i pronave komunale, Auditori ka konstatuar parregullsi në zbatimin e rregullores numër 23/2013 për përcaktimin e procedurave në dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme ku rezulton se 41 qiramarrës kishin borxhe të pashlyera ku vlera e tyre është 13 mijë e 930 euro. Tash pyetja i bie, në këtë kuptim a është në këtë rast edhe dikasteri përgjegjës a ka ndonjë plan të veprimit për

mbledhjen e këtyre borxheve apo është vullnet që i njëjti të përdoret për prona komunale pa pagesë. Nuk kam diçka tjetër tri çështje i pata.

Kryesuesi, faleminderit Arben!

Fjalën e ka kërkuar Arif Elshani.

Arif Elshani, përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë mendoj që Raporti i Auditimit u përmend që është i pamodifikuar apo i klasifikuar. Unë po e marrë një shembull të ndërmarrjet private, nëse 3 vite një ndërmarrjes i shkon i modifikuar shteti është i detyruar që të dërgojë administratorin. Nëse unë si ndërmarrja ime shkon 3 vite mua duhet me ma dërguar, se nuk ma dërgojnë, nuk ka ngjarë ,por me ligj duhet kështu, nuk e di në Komunë, çka ndërmarrin apo çfarë ndëshkimesh ka nëse paraqitet i modifikuar, por unë shumë kam lexuar raporte të komunave, dhe nuk kam parë ndonjë rast që ka shkuar i modifikuar prej auditorëve. Që d.m.th unë mendoj kjo nuk është që ne të ndihemi të rehatshëm në këtë rast nëse nuk jemi modifikuar por jemi mirë. Nuk po dua të them që ka ndryshime prej të kaluarave por ka ende që është për shqetësim zbatime e rekomandime nga 18 janë përfunduar 6, disa po kryhen, e 8 janë të pa përfunduara, unë mendoj që aty duhet kryesisht menaxheri i Komunës në këtë rast kryetari i Komunës të ndërmarrë masa në vitet në vijim mos të përsëriten. Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, kemi rast që klasifikohen, kemi raste që kemi shkuar na i kanë marrë paret thesari, kemi rastet e përmbaruesve që vlerat e ndëshkimeve janë të mëdha nga 2.700,00€ t'i merr edhe 1.800,00€ që d.m.th i bie 40% se lënda kur shkon te përmbaruesi aty shpenzimet rrjedhin dhe janë shpenzime të mëdha për Komunën dhe çdonjërin, unë jam i vetëdijshëm se komunat tjera e kanë situatën shumë më të keqe se ne, por duhet që në të ardhmen të mendohet që edhe këto të eliminohen që mos të bëhet si një përsëritje çdoherë e njëjtë. Të hyrat i kemi të planifikuara 1 milion e 200 mijë, i kemi 1 milion e 83 mijë që d.m.th 85% i kemi të realizuara të hyrat vetanake në vitin e kaluar. Mangësi në menaxhim të raportimit të të hyrave edhe kjo paraqitet si çdoherë, por unë mendoj që këto munden edhe të përmirësohen në të ardhmen. Shfrytëzimi i parregullt i pronave komunale, edhe këto janë përsëritur çdoherë, aty thuhet që pronat komunale shfrytëzohen nga 41 qiramarrës, borxhi i tyre është 13 mijë euro, por ndoshta ish dashtë të gjendet një mënyrë që këto mos të përsëriten në të ardhmen, që ata njerëz që po i uzurpojnë ato prona, një kohë disa ditë thonë që këto janë tonat nuk po na ngacmon askush. Komuna ka të angazhuar 42 punëtorë prej tyre thotë mos mundësia për punësim të përhershëm por edhe ajo nuk është e mirë, ndikimi është negativ pasi që nuk u epet konkurrenca, mundësia e konkurrencës njerëzve të tjerë , kjo dyshohet se mund të punësohen vetëm njerëzit që janë të afërt me Komunën dhe jo tu epet mundësia njerëzve tjerë që të aplikojnë apo të zënë një vend tjetër të punës. Investimet kapitale i kemi pas 8 milion e 700 mijë i kemi shpenzuar vetëm 3 milion e 700 mijë kjo është e qartë për atë projektin që është me kredi marrje por ky është një krahasim ndoshta është negativ për opinionin ata nuk e din pse ka ardhur deri te kjo. U fol edhe përpara, te kontratat që i kemi 40

mijë euro për kontrata jo kornizë edhe kjo një vërejtje që paraqitet çdoherë por unë mendoj që kjo mundet ish dashtë me u përmirësuar. Oferta fitues jo ekonomike shpërblehet me një kontratë kur të vjen përfundimi del më shtrenjtë sikur ai që ka qenë më i shtrenjtë në ofertë edhe kjo është një e metë, nuk mundet njeri me e klasifikuar, çfarë mënyre, për çka vjen deri te ajo por kjo mund të them që është përsëritur edhe në vitet e kaluara, edhe pse në vitet e kaluara Zyra e Prokurimit ka pasur vërejtje edhe më shumë se këtë vit. Shpenzimet shtesë si pasojë e pagesave me vendime gjyqësore e thamë edhe më herët që këto janë shpenzime prej 44 mijë eurove, 2700.00€ kemi vetëm ndikim aty negativ për Komunën, ose një vend 870.00€ tjetrin, 1180.00€ çka thashë edhe më herët shpenzimet janë shumë të larta nëse veç shkon te përmbarimi. Kontratat e nënshkruara në mungesë të fondeve edhe këtë ish dashtë me e pasur parasysh se janë të sanksionuara me ligj por sidoqoftë këto po ngjajnë çdoherë. Pasuritë kapitale dhe jo kapitale, këto nuk janë të regjistruara çdoherë, paraqitet problem mos regjistrimi i tyre, drejtori e dha një arsyetim, por unë mendoj që komuna duhet t'i kushtojë një rëndësi më të lartë kësaj pune sepse pasuritë kapitale mos të regjistrohen ashtu siç duhet. Faleminderit kaq kisha për sot!

Kryesuesi, faleminderit Arif!

Është lajmëruar Eliot Kukiqi dhe Labinot Aliaj.

Eliot Kukiqi, përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Drejtori dhe kolegët i ceken gjitha këto të Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Unë e kam një nën çështje, pse janë përsëritur këto, pse nuk janë zbatuar këto rekomandime : 1 klasifikimi adekuat i shpenzimeve, shfrytëzimi i parregullt i pronave, mbulimi i pozitave të rregullta të punës me kontrata për shërbime të veçanta, ndryshimi i sasive të para masave për kontrata jo kornizë pa aprovimin e ZKA-së, shpenzimet shtesë si pasojë e pagesave përmes vendimeve gjyqësore përmbarimore, kontratat e nënshkruara në mungesë të fondeve, mangësitë në regjistrim kontabël të pasurisë, rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme dhe mungesa e raportimit të detyrimeve të papaguara, d.m.th. këto janë përsëritur prej vitit të kaluar edhe këtë vit. Pse nuk janë zbatuar këto rekomandime? Faleminderit!

Kryesuesi, faleminderit Eliot!

Labinot Alijaj e ka kërkuar fjalën.

Labinot Aliaj, faleminderit kryesues! Unë vetëm desha të lidhem te ajo që tha drejtori në lidhje me realizimin e projekteve për vitin 2019. Nëse e shohim tabelën nr.1 te pika 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit, atëherë kemi 96% të realizimit të projekteve nga grantet qeveritare, ndërsa kemi nga të hyrat vetanake 65%. Ajo çfarë unë po dua të kërkojë është që me pasur fokus edhe në përfundimin e projekteve nga të hyrat vetanake të parapara me fondin nga të hyrat vetanake, që jo çdoherë t'i kalojmë nga viti në vit, për shkak që ato të hyra d.m.th e dimë të gjithë që nuk humbin, ndërsa fokusi jonë të jetë tek grantet qeveritare pasi që ato fonde humbin.

Kështu që të fokusohemi edhe këtu e t'i kryejmë edhe këto projekte të cilat po i parashohim me të hyrat vetanake dhe jo vetëm të fokusohemi tek ato që janë nga grantet qeveritare. Kaq kisha. Faleminderit!

Kryesuesi, faleminderit Labinot!

A e dëshiron dikush tjetër fjalën. Drejtori i drejtoratit për Buxhet dhe Financa lidhur me disa pyetje që u shtruan këtu sigurisht ka sqarime dhe përgjigje për to.

Edhe njëherë drejtor, po mendoj gjithë anëtarët e kuvendit përveç shqyrtimit të Raportit të Auditimit është fjala edhe për Planin e Veprimit për mënjanim i cili duhet të aprovohet.

Hysni Maxharraj, unë veç ju dhashë përgjigje gati të gjithëve.

Kryesuesi, Kryetari po e dëshiron fjalën.

Kryetari, unë mendoj që shumë herë e kam përsëritur, për këto nuk është rasti i parë që e shqyrtojmë një Raport të Auditimit. Është një çështje krejt çka keni folur saktë është. E saktë është se ne këtë e kemi pranuar ju nuk di a e dini, kur neve na vjen Raporti i Auditimit ne dy faza na vjen, si draft na jepet një mundësi 1 muaj na qitën në tavolinë, vërejtjet e tyre që ata i kanë prezantuar të ju japim përgjigje. Të gjitha i kemi pranuar, i kemi pranuar si vërejtje, kjo është e saktë se nuk kemi mundur me i mohuar se ashtu janë. Ato vërejtje që po i bëni ju janë edhe vërejtje të Auditorit prandaj po i pranojmë edhe të juajat. Tema është esenciale kjo po më pëlqen! Pyetja pse rekomandimet që janë bërë vitin e kaluar sa janë realizuar, edhe çka duhet të bëhet për me i realizuar rekomandimet e Auditorit? Unë e di, kanë me kaluar edhe bukur disa vjet që numri i rekomandimeve gjithmonë ka me ekzistuar, një vërejtje ka me ekzistuar ,nuk kemi me arrit përsosmërinë me një fjalë nuk ka shanse. Vërejtjet që janë bërë të gjithë po i potenconi, që më të mëdha janë pikërisht te pronat, te menaxhimi i pronave, uzurpimi i pronave, këto janë duke na sjellë telashe, kjo është punë e madhe edhe e shtetit, nuk pres ndonjë zgjedhje spektakolare këtu, janë disa vërejtje që janë rezultat i neglizhencave tona mos komunikimit tonë të brendshëm, që ato duhet me u fokusuar edhe me i eliminuar, disa ta dini që keni me i pas edhe vitin e ardhshëm të jeni të sigurt, d.m.th vitin e ardhshëm për këtë vit, nuk kemi pas mundësi krejt, goxha mirë i kemi përmirësuar disa rekomandime, krahasuar me vitet paraprake jemi fokusuar më shumë, prandaj unë do të insistoj që tha Arifi , menaxher faktikisht mua më bie, se të gjitha rekomandimet mua më i adreson, askujt tjetër, askush nuk përmendet as drejtorin këtu është problemi esencial, do të bëjmë përpjekje me i eliminuar të gjitha këto defekte. Janë edhe procedurat, nganjëherë futemi edhe në panik, në kuptimin e realizimit të projekteve, nganjëherë gjejmë variante, aty Labinoti po e thotë mirë nuk po di as si ta them, tash nuk po fokusohemi aty se nuk mundemi me arrit në të dyja, po kemi telashe po na vonohen projektet, po fillon viti fiskal në maj dhe po mbyllet në tetor, edhe sa kemi kohë me i mbyll të gjitha procedurat, deri në fund të tetorit, me të vërtetë është problem, gjithë

kjo listë e projekteve që keni me i parë për vitin e ardhshëm, krejt kalojnë nëpër procedurë. Bile unë e thashë një ditë a i bëjmë katër projekte? Katër projekte po i bëjmë të mëdha, investime kapitale edhe nuk po merremi me këto, po tash janë kërkesa edhe te juaja, të drejtorëve, të qytetarëve, jo unë po e dua një kanal aty 50m, jo 100m, jo një asfalt edhe atëherë të gjitha procedurat janë të njëjta, si për projekte milionëshe si për këto projektet e vogla, si procedura e kam fjalën e kanë afatin e vet, edhe këtu pastaj po duhet të jetë edhe një ekip shumë i madh që me pas mundësi me i realizuar deri në fund, aty mund të ndodhin edhe shkelje, mund të ndodhin edhe gabime procedurale, prandaj janë këto gjëra që po mundohemi me i bërë. Edhe asnjëherë nuk kam thënë që jam i kënaqur, nuk jam i ekzaltuar me këtë lloj raporti të jeni të sigurt. Ta ndihmojmë njëri tjetrin edhe të shohim, jepni vërejtjet e juaja, unë e di që ka plot prej jush në asamblenë komunale që saktë e dinë ku janë defektet dhe ku janë vërejtjet, thojeni, luani lojën e auditorit, i fusim edhe në rekomandime nuk ka problem. Kjo është puna e juaj. Nuk besoj se duhet me na cituar vërejtjet që na ka jap Auditori, ata na kanë jap Auditori, ne e kemi pranuar si të tillë e ja u pranojmë edhe juve. Unë jam i interesuar me u koncentruar në rekomandime, sa ma profesionale që të jepen edhe në planin e eliminimit të rekomandimeve.

Kryesuesi, faleminderit Kryetar!

Hysni Maxharraj, te zbatimi i rekomandimeve të vitit të kaluar d.m.th. gjashtë janë zbatuar tri janë mbyllur edhe një është në proces. D.m.th. ne e kemi mbi 50% realizimin e rekomandimeve të vitit të kaluar pra jemi mbi mesatare të vendit pra janë mbyllur, nuk i auditojnë më këto tri rekomandime që kanë qenë për atë arsye janë të mbyllura. Dhe te Arifi, nuk është raporti i modifikuar, se dallon raporti i modifikuar prej raportit të pa modifikuar. Raporti i pa modifikuar është i dyti në radhë më i miri, d.m.th. i modifikuar është kur organizata buxhetore nuk prezanton, heziton që t'i përgjigjet kërkesave të Zyrës Kombëtare të Auditimit. D.m.th vitin e kaluar e kemi pasur të pa modifikuar me theksim të çështjes, e në këtë vit nuk kemi theksim të çështjes, pra e kemi raportin e pa modifikuar që do të thotë është në nivelin më të lartë të opinionit. Këto tjerat te shpenzimet kapitale përmendi aty është ajo kredia në plan, nuk është dashtë me na e qit neve në realizim të buxhetit, kur nuk i kemi pasur mjetet e alokuara, d.m.th. 5 milion e 94 mijë por është dashtë me na i qit 2 milion e 550 mijë, ato mjete çka i kemi pasur të alokuara për me qenë në raport edhe këtë vit është përmirësuar, këtë vit i kemi vetëm mjetet që janë të alokuara jo edhe të planit, për ata ka arritur edhe deri te një plan.

Kryetari, Hysni, edhe një ndërmjetësim, e përmendi 68% është këtu në raport që është realizuar në investime kapitale. E kemi humbur një grant, pikërisht për këtë punë që e përmenden. E realisht realizimi i projekteve kapitale ka qenë mbi 80% afër 90% kemi ra e kemi humb një grant. Kjo është e vërteta. Mirëpo unë mendoj që kemi fituar në aspekte të tjera që e kemi mbuluar atë grant të jeni të sigurt kam me ja u

argumentuar se ku është mbuluar ai grant me mungesë të asaj. Prej dy pikave tjera që do të jenë në raport financiar.

Kryesuesi, të nderuar anëtarë, a e dëshiron dikush tjetër fjalën?
Arif Elshani urdhëro.

Arif Elshani, z. Drejtor the tri çështje nuk janë hequr. Çka do të thotë që nëse janë hequr prej listave të Auditimit ti nuk je marrë me to. Nuk je 50% por je nën 50%. Nëse ti nuk i ke shqyrtuar dhe nuk i ke eliminuar ato tri çështje ti nuk e ke kryer punën tënde nuk je në 50% se edhe ne pak dimë matematikë. A po më kupton se çka po dua të them. Të lutem po kapesht për një punë shumë të thjeshtë dhe po dua të të them, raporti thashë që është më i mirë se vitin e kaluar, por nuk është prej të mirëve nuk është për me u lëvduar për atë raport. Nëse tri vjet ti shkon me raport të klasifikuar çka bëhet me ty? Po veç nëse shkon unë po të pyes ty? Edhe unë thashë asnjë komunë më Republikën e Kosovës nuk e kam parë që e kanë modifikuar asnjë. Të gjitha janë pak më mirë e pak më keq, edhe pse çështjen financiare e kanë shumë me keq se ne, me fol drejtë shumë ma keq se ne. Faleminderit!

Kryesuesi, Faleminderit Arif! Kryetari e ka fjalën.

Kryetari, Raporti i Auditimit është më i mirë se i viteve tjera. Mirëpo nga ana tjetër kurrë nuk ka qenë më i keqi, këtu dijeni këtë punë. Merreni lexojeni raportin, merrna me këtë punë që 20 vjet, e njoh shumë mirë këtë punë nuk ka qenë më i mirë se kësaj radhe, gjithmonë ka qenë i pa kualifikuar në kuptimin pozitiv.

Kryesuesi, faleminderit Kryetar!
Agron Avdijaj e ka fjalën.

Agron Avdijaj, në po e kuptojmë që këtë herë në cilësinë kryesore po del më mirë se vjet raporti, mirëpo prapë ne po insistojmë që i pa modifikuar janë mbi 20 komuna që e kanë marrë të pa modifikuar d.m.th nuk është ndonjë krenari aq e madhe, këtë po dua ta them, se kjo i pa modifikuar janë edhe mbi 20 komuna tjera që e kanë marrë.

Kryetari, Agron me theksim të çështjes.

Agron Avdijaj, vjet e kemi pasur me theksim të çështjes, edhe tjetra që mua po më shqetëson këtu e sigurisht është edhe në komuna tjera, po meqenëse unë këtu jam më shumë i përfshirë, përsëritja e gabimeve të njëjta, kjo po të tregon që kjo është pyetja, që e bëri edhe Elioti edhe që po e bëjmë ne si asambleistë, pse nuk po ndërmerrni që mos me i përsërit gabimet ose me u përsërit më pak. D.m.th 7-8

rekomandime janë të njëjta me vite të më hershme që po përsëriten, kjo përsëritja po bëhet shqetësuese. Faleminderit!

Kryesuesi, faleminderit Agron!

E për ata po mendojmë, po shpresojmë, që Plani i Veprimit për mënjanimin e të gjeturave të cilin veç e keni përpara, do të kemi një raport edhe gjatë vitit të ardhshëm lidhur me këtë plan për realizimin e saj, prandaj do të merren masa sigurisht.

Dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Jo.

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi, atëherë kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. E keni një propozim vendim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, dhe e keni pasur edhe në material, ne e kemi aprovuar më herët një Rregullore për tatime në pronën e paluajtshme, janë këto norma që janë të parapara aty, normat pothuajse janë minimale unë lidhur me këtë ja përcjell fjalën Drejtorit për Buxhet dhe Financa.

Hysni Maxharraj, prezanton pikën e 5-të të rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020-2021.

Kryesuesi, faleminderit drejtor! Besojë që është e qartë se çka po kërkohet.

E keni propozim-vendimin, a ka dikush diçka nga anëtarët e Kuvendit lidhur me këtë? Nuk është lajmëruar askush, atëherë pyes anëtarët e Kuvendit kush është për që të miratohet ky propozim-vendim, lidhur me caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020-2021? Kush është për?

Konstatojmë që Kuvendi unanim miratoi këtë propozim-vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020-2021.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës ' Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Buxhetit të komunës për periudhën 2021-2023.

Materialin e keni, ja përcjell fjalën Drejtorit për Buxhet dhe Financa të na raportojë lidhur me Draft Buxhetin, mendojë që keni nevojë me e shikuar edhe në ekran.

Hysni Maxharraj, prezanton pikën e rendit të ditës ' Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Buxhetit të komunës për periudhën 2021-2023.

Kryesuesi, faleminderit drejtor për këtë prezantim të Draft Buxhetit, unë e përcjelli fjalën te anëtarët e Kuvendit, janë lajmëruar dy anëtarë të Kuvendit, Naim Imeraj dhe Valbona Demaj.

Naim Imeraj, shkurt shumë më shkurt se zakonisht. Pikësëpari për drejtorin ka vazhduar në vazhdimësi me u përcjell një mospërputhje por besojë është një gabim teknik tek shpenzimet kapitale, financim i jashtëm, është një mos përputhje në vlerë dhe përcillet prej versioni në version prej 1640.00€ është te kodi 660. Kështu që veç si sugjerim që me e shtuar, që me pas mundësi me dalë shuma. Nuk është diçka e mençur ajo çka e thashë, por ma e mençur do të ishte kjo që prej procesit të diskutimit publik ja kemi shtuar këtyre financimit të jashtëm edhe një 755 mijë euro kështu që i kemi gati 9 milion euro financim të jashtëm kështu që mos të habitemi që nuk i kemi projektet, se projektet i kemi, kanë prioritet të caktuar të financimit, këtë duhet me e ditë edhe kolegët, prej burimit 10, d.m.th grantit, prej të hyrave vetanake që është i luhatshëm për shkak të rrethanave edhe burimeve të jashtme të financimit të jashtëm i cili është hipotetik kryesisht hipotetik. Sa i përket listës së propozimeve të projekteve kapitale së pari, kisha dashtë me e heq dilemën time kjo 'blerje dhe furnizim' a ka konflikt emërtimi 'blerje dhe furnizim' se herë e kemi ,herë nuk e kemi, do gypa të ujësjellësit varësisht prej periudhave të caktuara të kanalizimit herë i kemi në buxhet e herë nuk i kemi, 'blerje dhe furnizim' a janë mallra dhe shërbime, a po për shkaqe të caktuara janë projekt kapital, edhe për cilat shkaqe të caktuara. Është një projekt te Shërbimet Publike prapë i cili e ka vlerën e caktuar prej burimeve të sigurta është emërtimi i ndriçimit publik në rrugët "Vëllëzërit Zeqiraj" "Esat Morina" dhe "10 Dhjetori" ku është kjo? Besojë që do t'i shtohet edhe ku e ka të caktuar. Vërejtja e asaj që diku është rrugë e pa përcaktuar diku është e specifikuar veç nuk e ka edhe numrin, vazhdon të jetë problematikë e listës kapitale të cilën ne në vazhdimësi e miratojmë. Tash a është çështje që ne vendosim varësisht prej fondeve në dispozicion apo do të vendosim për shkaqe rrethanore të momentit kur aktivizohet projekti atëherë mbetet si çështje, që besojë se ju e dini përgjigjen por pak a shumë përgjigjen mund ta dimë edhe ne. Te shërbimet, te 730-shi Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale është një projekt i cili e ka emërtimin e njëjtë, por ndodhet në dy nën programe të ndryshme, janë dy gjipa një vend dy gjipa një vend, a janë katër gjipa, dy për shëndetësi e dy për mirëqenie sociale apo janë dy gjipa të përsëritur, se njëri e ka 20,000.00€ e tjetri 25,000.00€ ? Edhe pak e çuditshme prej krejt këtyre 755 mijë eurove, në procesin e kalimit nëpër diskutim publik për të cilin kam vërejtje të vazhdueshme, se ne kemi një Rregullore për rregullim të këshillave të fshatrave që

nuk e kemi zbatuar kurrë për çka e dimë na, kryesisht është hipotetike ajo nuk është zbatuar kurrë edhe si të tilla nuk kemi këshilla të fshatrave dhe planifikimit buxhetor i bëjmë ashtu si i bëjmë gjithmonë përmendet drejtori edhe normal si të përmendet drejtori aty është e kuptueshme që faza e fundit një ditë para buxhetit është edhe diskutimi publik për njerëz që kanë vullnetin me ardhur në sallë, edhe prej krejt atyre projekteve ka kaluar veç një projekt këtu, ju kanë heq Istogut prej rrugëve 20 mijë euro edhe kanë shkuar te rruga “Rexhë Kastrati” në Kashicë, po më vjen keq kush do që preket në këtë interes, asgjë personale 20 mijë euro, po më intereson pse u filtrua kjo bash ai projekt, ku është prioriteti i atij projekti që prej krejt diskutimit publik ky projekt ka ndërhyrë në versionin para diskutimit publik. Këto ishin vërejtjet dhe pyetjet e mia. Faleminderit Kryesues!

Kryesuesi, faleminderit Naim!

Kryetari, unë veç këtë pyetjen e fundit, e tjerat mundesh me ju përgjigjur ti. Kjo te “Rexhë Kastrati” ka shkuar me intervenim timin pak, a din pse? Ky ka qenë një projekt, një rrugë që është bërë para një 4-5 vjetësh dhe ka qenë me bashkëfinancim, edhe ka shkuar deri te një lagje “Kastrati” atje në Baicë edhe nuk ka përfunduar deri në fund sepse nuk ka pasur më shumë mjete, mirëpo ajo pjesa tash që po e fusim ne që kanë qenë edhe participues të projektit paraprak, kështu që u a kemi bërë pak me hile edhe është një rrugë nëse e keni parasysh ai që e din atë terren, rruga që shkon prej Banje vazhdon atje për Kashicë, në anën e djathtë është lagja “Kastrati” dhe vazhdon edhe një rrugë tjetër që lidh deri te kjo penda, nuk shkon deri ne fund është një lagje bukur e madhe edhe kjo është ajo. Nuk ka qenë diçka, edhe këtu ka qenë edhe një intervenim nuk e di a është përmirësuar, sigurisht ka me bërë pyetje dikush. Kemi ndarë aty një projekt në arsim që kam intervenuar me kohë nga Banja, oborri i Banjës atje dhe e kemi dërguar në shkollën e Veriqit, për një arsye që e kemi vlerësuar, nuk e kemi vërejtur aty janë disa mjete të pamjaftueshme, i kemi heq prej Banje i kemi rrit 35 mijë euro në Veriq i kemi dërguar komplet, për një arsye që ajo shkolla dhe hapësira ka nxënës të konsiderueshëm aty dhe vlen me intervenuar pak më shumë në renovimin e shkollës dhe hapësirave aty, kjo ka qenë ideja, d.m.th nuk ka qenë ideja me ja bërë me hile askujt kjo është. Naim unë natyrisht më qejf kam ndoshta në Istog se me i dërguar te “Rexhë Kastrati” aty por problemi se këtu në Istog po bëjmë diçka i kemi disa projekte që janë duke u zhvilluar në Istog dhe kapem disi.

Naim Imeraj, kërkoj falje Kryesues, nuk është replikë, besoj që prej të gjithë këtyre mandateve që i kom këtu ose në një sallë tjetër, jam në mesin e atyre që së paku asnjë herë nuk ka thënë diçka që po i vjen te dera vet, ndoshta kam thënë diçka që shkon në një regjion për të cilin unë jam i lidhur emotivisht ose familjarisht, por nuk ka të bëj me atë kështu që krejt pyetjet janë në aspektin e qartësisht, nuk po dua as me u arsyetuar në raport me ty, por thjeshtë janë çështje për arsyetim, faleminderit Kryesues edhe njëherë!

Kryetari, edhe një çështje tash e kanë thënë drejtorët ndryshe, unë po e shoh që ende kemi ra në at ndikimin, se sigurisht kjo është rezultat edhe i këtyre kërkesave parcialesh që ndodhin krejtësisht lokale, unë e thashë një ditë edhe në komitet, ideja ime është pak më ndryshe, kem kaluar një fazë të zhvillimit, krejt kjo listë e projekteve këtu, unë e kisha shndërruar në 10-15 projekte definitivisht, por unë e di që nuk kemi me pas mundësi me arrit pajtueshmëri, një drejtor anon një pjesë, tjetri aty, i kanë qit ato kriteret, besa mos harroni ka edhe efekte zgjedhore, ndodhin këto. Edhe këshilltarët edhe qytetarët anojnë nga pjesët e tyre, këto janë edhe debate. Unë gjithmonë e kam përsëritur edhe po e përsëris, kurrë nuk kam qenë i kënaqur me propozimet e buxheteve kurrë, nuk besoj që jeni as ju, askush nuk e ka bërë me shije të vet, e me pas mundësi me e arrit një konsensus do ishte mirë ose një shumicë në fund të fundit.

Kryesuesi, faleminderit Kryetar!

Enver Rugova e ka fjalën.

Enver Rugova, përshëndet të gjithë të pranishmit!

Këshilltari Naim Imeraj e dha këtë vërejtje mirëpo edhe në aspekt prokurativ të tekstit, në atë që auditorët faktikisht po na japin vërejtje vazhdimisht në emërtime, ka lëshime mirëpo këtu është saktë 'blerja dhe furnizimi' d.m.th blihet dhe furnizohet d.m.th franko ju dërgohet atyre që bëjnë kërkesë në drejtorinë tonë. Sa i përket ajo, kapital është se Auditori na ka dhënë vërejtjen që keq klasifikohet d.m.th më mirë kishe me qenë edhe kjo edhe sinjalizimi edhe mirëmbajtja e projekteve infrastrukture të jenë në mallra dhe shërbime, d.m.th të keq klasifikohet, nuk e di pse ka mbetur kështu. Me kalimin e kohës Kryetar ne mundemi edhe me i fut në mallra dhe shërbime këto tash drejtori e di më mirë.

E për këtë në Banjë, ne veç kemi filluar mirëmbajtje të ndriçimit publik do ti përfundojmë këto dm.th këtë projektin në Banjë, është prej rrugës "Vëllëzërit Zeqiraj" edhe këto dy rrugët janë pa ndriçim publik ata kanë investuar në shtylla diçka, ne do të ju ndihmojmë me i kompletuar sigurisht të tri rrugët aty. Faleminderit!

Kryesuesi, faleminderit Drejtor!

Fjalën e ka Hysni Maxharraj.

Hysni Maxharraj, këtu te gjipat është gabim teknik, është përsërit përshkrimi dy automjete- gjip, për nevoja të shërbimeve d.m.th është një gjip për nevoja të shërbimeve sociale dhe një gjip për nevoja të shëndetësisë. Do të hiqet ky emërtim, d.m.th. një është për shërbimet sociale dhe një për shërbimet e shëndetësisë primare. Te keq klasifikimi është përmbush ajo kuota të mallra dhe shërbime kjo është shumë

projekte qe kemi heq, që kanë qenë të keq klasifikuara, por të shohim tash edhe me konsultim me Ministrinë e Financave a do të jetë ky projekt i keq klasifikuar, nëse po atëherë do ta zhvendosim.

Kryesuesi, faleminderit Drejtor!
Fjalën e ka Valbona Demaj.

Valbona Demaj, përshëndet të gjithë të pranishmit! Nuk kam diçka me shtuar sa i përket draft-buxhetit e shoh që disa projekte janë realizuar në fshatin Dubovë e vogël, d.m.th projekti i kanalizimit, projekti i mbledhjes së mbeturinave, projekt kyq edhe betonimi i kanalizimit, desha të falënderoj që është përfshirë në planin zhvillimor për tri vitet e ardhshme, mirëpo është kërkesë e vjetër sepse kemi tre fermerë dhe d.m.th është çështje primare, të gjitha projektet janë të mirëseardhura mirëpo është çështje primare për betonimin e kanalit në Dubovë të vogël. Edhe sa jemi te çështja e pandemisë desha të falënderoj personalisht Kryetarin me stafin e tij se kanë bërë një menaxhim shumë të mirë, d.m.th e kam pasur përvojën në familje, e kanë bërë menaxhimin e mirë, dhe jemi ndër komunat e para besoj, që kanë bërë kaq menaxhim të mirë me stafin e tij. Ju falënderoj përzemërsisht Kryetar ju dhe stafin!

Kryesuesi, Agron Avdijaj e ka fjalën.

Agron Avdijaj, faleminderit Kryesues! Sa i përket draft-buxhetit, nuk po dua me u ndal në projekte të caktuara, mirëpo po dua me i radhitur në disa elemente ku unë i kam vërejtjet dhe vazhdimisht po shkojnë po përsëriten këto. Ndarja e prioriteteve që realisht lidhet shumë me atë që e tha kolegu Naimi, mungesa e këshillave lokale, d.m.th. ku bëhet prioritizimi i projekteve, sepse kur kjo nuk funksionon atëherë lind nevoja e përzierjeve të projekteve se kush është më i forti në katund, kush ka ndikim më të madh, e gjen lidhjen e gjen drejtorin e gjen kryetarin edhe e shtyn projektin, e që për mendimin tim kjo është qasje e gabuar, unë e di që nuk mundeni me i ik vazhdimisht kësaj, mirëpo mundeni me e ndal këtë trend, ndoshta është edhe njëra prej arsyeve pse nuk po funksionalizohen këta këshillat e fshatrave ku fshati pak si më unik vijnë me propozime të caktuara, jo me ardhë një individ për një interes të vetin apo për një lidhje që mund ta ketë në Komunë, edhe mundet me e ec projektin, kjo është vërejtja e parë. Vërejtja e dytë është te keq klasifikimi që lidhet edhe me vërejtjet e raportit të auditorit dhe që për mendimin tim prape kjo që po them gabimi bëhet me qëllim, se nëse mallra dhe shërbime hyn në shpenzime kapitale atëherë po rritet në projekt këtu kaq kemi shpenzuar në shpenzime kapitale sa që nuk është reale pastaj se po ndikon buxheti i keq klasifikimit me ti rritur ty investimet në shpenzime kapitale. Ana tjetër ky ndërrimi i projekteve, jo gjithmonë po argumentohet , si shembull po e marrë nuk po dua të jem lokalist nuk kam qenë

asnjëherë, por p.sh, ndërtimi i kanalizimit në fshatin Moistir, në Sinajë ka qenë i planifikuar diku në vlerë 80 mijë euro, tash në këtë pasqyrim nuk po e shoh hiç, d.m.th. është zero. Nuk e di ku është dedikuar kjo që nuk është bërë atje dhe pse. D.m.th. a ka ndonjë arsyetim. Pastaj e kemi kullimin e tokave bujqësore e që mendoj që edhe aspektit të bujqësisë në këtë buxhet nuk i është kushtuar hapësirë e mjaftueshme, përderisa jemi si komunë në vend bujqësor ,mendoj që duhet me e pasur një fokus më të madh në këtë drejtim. D.m.th është hequr, ka qenë më herët por është hequr në vlerë diku 40 mijë euro, tash veç nëse ka keq klasifikime në këto ato mund ti argumentoni ju. Këto pak a shume edhe për ambientin, me thënë të drejtën nuk po shoh projekte që kanë me ndikuar në këtë çështjen e ambientit, deponitë, këtu është me rëndësi që të ju kushtohet rëndësi me projekte të caktuara edhe këtij sektori. Faleminderit! Pak a shumë këto janë vërejtjet e mia, për mos me u leshu tash në filan rrugë.

Kryetari, Agron, i kemi hequr, ke të drejtë atë që e jep si vërejtje, për një arsye, e kemi parë me vite që po dalin të pa suksesshme në kuptimin se na e kem problem e keni aty në listë aty lumin, pa hapjen e lumit të Istogut, kullimi e humb kuptimin. Nuk po kemi ka me e dërguar ata ujë unë jam dëshmitar vet i tokave që kemi ne në Cerrcë e Lluga e me radhë e hap një kanal të ujitjes, lumi është ngrit edhe nuk ke as ku e derdh, edhe po shkojnë paret kot, prandaj e kem lënë që deri sa nuk e hapim lumin nuk kemi nevojë me bërë as kullime, kemi telashe aty janë shtruar një pjesë e madhe të kënetave, tash unë këtë e kisha fut edhe si pjesë të projektit ' pastrimi i lumit, hapja e lumit është tepër ambiental bile tepër e rëndësishme nëse del e viziton lumin e Istogut a Vrellës a përrojet tona janë tmerr, të pa pastruara ,unë jam pro asaj që e thashë unë i kisha fut 1 milion euro prej investimeve kapitale për pastrimin e lumit të Istogut, kjo është ajo teoria që po dua me ja u thënë unë juve, ti parcializojmë gjërat, ta pastrojmë lumin atëherë gjërat janë më të lehta. Sa i përket kjo edhe një pyetje që e bëre në fillim.

Agron Avdijaj, kanalizimi po mendon në fshatin 'Miostir.

Kryetari, tash ta jap përgjigjen Enveri, po ke edhe një tjetër formimi i këshillit të fshatrave, në Raportin e Transparencës Komunale një ndër vërejtjet ka qenë edhe mos formimi i këshillave të fshatrave, po ju a them një gjë të saktë disa Komuna e kanë bërë, e ka bërë Peja, e ka bërë Vitia, të gjithë kryetarët e Komunave në diskutimet publike që i kanë bërë të gjithë janë të pakënaqur edhe ata e quajnë krejt formimin e këshillave të fshatrave gati si formal, sa me e plotësuar një kriter i kërkuar në bazën e atyre kriterëve besojë që kjo ka qenë. Keq është ashtu, unë nuk po dua të them që ne ja kemi qëlluar që nuk e kemi formuar se kanë rezultuar të pasuksesshme, mirëpo ne nuk e kemi formuar për disa arsye të tjera, nga pak neglizhenca, është kërkuar një buxhet aty asnjëherë nuk e kemi fut po aty ka qenë problemi, mirëpo besoni që në punën e këtyre kërkesave që i bëjnë fshatrat nuk punojnë me individ, zakonisht vijnë grupe të njerëzve, ata njerëz që vijnë në këtu në debate publike ata i kanë kërkesat individuale por gjithmonë ato janë mbështetura

diku, te unë vijnë së paku 4-5 njerëz ku i bëjnë këto marrëveshjet e participimit nuk i shikoj ato nuk e kam atë telashe, në kuptimin e politikave që munden me u bërë, këto kanë qenë arsyet se nuk e kemi bërë me inat aty, nuk kemi dashtë me dominuar as politikisht as asgjë. Kjo është ajo përgjigjja. Nëse nuk futet çështja e këshillave të fshatrave si kategori kushtetuese ligjore nuk mund të funksionojnë kur të bën një Kryetar të këshillit të fshatrave të bashkësisë lokale duhet me e fut në listë të pagave, ndryshe nuk funksionon.

Kryesuesi, faleminderit Kryetar! Lidhur me këshillat e fshatrave është e vërtetë që e kemi një Rregullore, ajo Rregullore duhet të ndryshohet nuk mund të funksionon ajo Rregullore, nuk ka funksionuar as në Komunat tjera, është një udhëzim administrativ i fundit i 2019 muajit të gjashtë, megjithatë edhe ky është ka diskutohet përsëri me u plotësuar, ende nuk është funksional.

Kryetari, qe urdhëroni, ndani 50 mijë euro ose 20-30 mijë euro, po i organizojmë zgjedhjet për këshilla te fshatrave.

Kryesuesi, është problemi i organizimit të tyre, është problemi i kompetencave të atyre njerëzve prandaj ende nuk është e qartë kjo.

Kryetari, fshijeni një ujësjellës çka të doni, kemi vendosur me e bërë organizimin e këshillave. Unë e di që vitin e ardhshëm është vit zgjedhor i bëjmë në pranverë, ose i bëjmë në vjeshtë e vonë, por po i bëjmë edhe sivjet.

Labinoti Aliaj, zgjedhën njerëzit e tu, nuk na konvenon, kështu që më mirë po e lëmë kështu.

Kryetari, shiko, Vrella e ka këshillin e fshatit edhe po ju them qartë ja u dha edhe me emër, kryetari i këshillit të fshatit është Idriz Blakaj. Edhe ai vjen prej Vrelle dhe unë komunikojë me të shumë mirë, shumë projekte shkojnë përmes tij, a po e shihni që bën edhe në këtë formë. Idrizi nuk është në parti me mua. As nuk ka qenë kurrë.

Agron Avdijaj, ndoshta edhe pse nuk po funksionon në Komuna tjera qe e tha Kryetari, pikërisht është ndoshta për shkak të tendencës d.m.th interesave partiake sepse edhe pagesa mund të zgjidhet diçka në fund të fundit mundet me u bë një kompromis, mirëpo me e pas një komunikim me tentuar unë besoj se bëhet zgjidhje, nëse jo në krejt fshatrat por fshatrat që kanë gatishmëri munden me e bërë këshillin siç po thua edhe në Vrellë, mund ta bëjmë jem në mënyrë më organizuar i shtrojnë kërkesat, por përpjekje është mirë me bërë, tash sa i përket aspektit ligjor është mirë me e shqyrtuar.

Kryetari, unë këtu i shoh këshillat e fshatrave këtu janë, ju jeni duke i përfaqësuar definitivisht, krejt po flisni, Valbona flet për Dubovën, ti flet për Moistirin e Sinajen.

Agron Avdijaj, unë kur fola për Sinajën e futa në thonjëza, me marrë si shembull që mos me ju hy krejt projekteve.

Kryesuesi, po besoj që është e qartë edhe një herë lidhur me këtë që u potencua është një udhëzim administrativ bazuar në të cilin do të nxirret edhe Rregullorja unike edhe Rregullorja jonë Komunale më vonë për organizimin e tyre, përndryshe nuk mund t'i bëjmë legjitime ato këshillat e fshatrave. Ne kemi udhëzimin administrativ mund të konsultohemi në faqe e Ministrisë i datës 28.06.2019 aty e parasheh numrin e këshillave të fshatrave shumë mirë por përsëri bazuar në të duhet të nxirret një Rregullore specifike edhe për Komunën edhe për nivelin qendror e më pastaj mund t'i zyrtarizojmë.

Kryetari, Qaush duhet ta kesh parasysh, i ki 50 fshatra zyrtarisht a po dëshiron me i formuar 50 këshilla të fshatrave ?

Kryesuesi, jo është e precizuar në udhëzimin administrativ sa mund t'i kemi bazuar në numrin e banorëve, merreni udhëzimin administrativ shikojeni, e harmonizojmë Rregulloren tonë bazuar në të dhe pastaj mund të vazhdojmë me të. Është e precizuar sa këshilla të fshatrave mund të bëhen. Mirëpo edhe një herë po e përsëris është hartim e sipër një Rregullore në nivelin e përgjithshëm e cila mund të na ndihmojë në hartimin e Rregullores tonë bazuar në këtë udhëzim. Këtu parashihet vetëm kryesuesi i këshillit të paguhet edhe atë për 6 takime. E ka edhe shumë gjëra tjera që tash nuk kemi nevojë, mund ta formojmë një komision lidhur me këtë më vonë dhe mund ta hapim.

Naim Imeraj, një fjali, deri sa ne të vendosim çka dëshirojmë me bë në të ardhmen në përputhje me udhëzime administrative që ndërkohe janë në fuqi, ne e kemi në fuqi një Rregullore e cila i përcakton.

Kryesuesi, nuk mund ta zbatosh.

Naim Imeraj, mirë atëherë duhet me e shfuqizuar, se përndryshe gjithmonë unë do të them kemi Rregullore, edhe sa herë që kam kërkuar që të raportohet këtu tash po

dalë prej temës, po gjithçka lidhet prapë te leku, prapë te buxheti lidhet, sa herë që kam kërkuar që të raportohet para neve anëtarëve të Kuvendit të Komunës, zbatueshmëria e Rregulloreve, kam menduar në këtë, kam menduar në Rregulloren për mirëmbajtjen e varrezave, kam menduar në shumë Rregullore të cilat realisht i kemi kryer, kemi shikuar a i kemi dhënë ndonjë vërejtje a jo, por kanë qenë të pa zbatueshme, ajo kjo, thjeshtë duhet me e filtruar atë, duhet thjeshtë me i heq se nuk janë më Rregullore deri sa nuk janë të zbatueshme kujt i shërbejnë ato? Më së pakti ekzekutivit. Faleminderit Kryesues!

Kryesuesi, faleminderit Naim! Nuk po vazhdojmë më lidhur me këtë mund ta hapim si temë në ndonjë takim tjetër.

E ka kërkuar fjalën Labinot Aliaj dhe Naim Behlulaj.

Labinot Aliaj, faleminderit Kryesues! Vetëm desha me u ndërlidh me ato çka u thanë kolegët në përshkrim të disa projekteve, p.sh është projekti të Dreitoria e Kulturës, ndërtimi i qendrës rinore në Uçë, një vend thotë 50 mijë tjetrin vend thotë 100 mijë, d.m.th 150 mijë brenda, ndërtimi i qendrës rinore në Uçë, nga burimet tjera d.m.th e përshkruar dy herë, njërin vend 50 mijë tjetrin vend 100 mijë, nëse e sheh drejtor e gjen aty, tani p.sh janë disa projekte si ky, rregullimi i shtratit të lumit Istog prej burimit deri te hotel "Trofta" që çdo vit shkon duke u bartur nga viti në vit edhe asnjëherë nuk u ndërmor diçka për këtë projekt, pak a shumë e dimë edhe arsyen pse, por po e lëmë ashtu. Nuk e di kemi pasur shumë propozime që i kemi dhënë edhe kur i keni bërë ato planifikimet po nuk po i gjej që kanë qenë për vitin 2021 të parapara, nuk janë. Kemi këtu p.sh ndërtimi i deponisë në Tyqep, nuk ka buxhet hiç të paraparë, për atë mendojë që është ndër projektet kryesore që ish dashtë me qenë, edhe kisha kërkuar një sqarim lidhur me të. E kemi hartimin e planit lokal për mjedis 2019-2024 janë diku të parapara 10 mijë euro nga burime tjera, mirëpo unë kërkojë që kjo kishte me qenë shumë e rëndësishme që me i ndarë mjete nga fondi i të hyrave vetanake që sa më shpejt me e bë këtë plan, se mendoj nuk e di nëse ka diçka më parësore se sa hartimi i një plani për mjedis sot për sot. Ju faleminderit!

Naim Behlulaj, faleminderit Kryesues! Përsëritet të gjithë të pranishmit! Në radhë të parë i falënderojë drejtorët për një shpërndarje të buxhetit edhe projekteve të cilat po duket që nuk kanë lënë vend pa prek nga pak, ju falënderojë për këtë ndarje, megjithëse kam dy pyetje. Pyetja parë shkon për drejtorin e Bujqësisë, është një rrugë në bjeshkën e Uçës, por ajo rrugë nuk e përfshinë veç Uçën mos të bëhem lokalist, e cila është diku përafërsisht që dy vite duke u kërkuar për hapjen e saj ku po rrezikohen çdo ditë jetët e qytetarëve rastin e fundit e kemi para tri ditësh është rrokullisur një traktor fatmirësisht njerëzit kanë shpëtuar, që lidhet Vojdullë Maja e madhe e ashtuquajtur Javorr që përfshinë prej Zhakovë-Shushicë-Uçë-Rakosh e lidhet me rrugën kryesore që ju e mirëmbani diku me gjatësi 1 km, nuk besojë që është ka më shumë, ndoshta e kushtueshme nuk mundet me qenë aq shumë sepse shumica është livadhe por kërkojë nga drejtori që të hynë në Kornizën për mirëmbajtjen e rrugëve ku do të bëhet hapja e kësaj rruge. Drejtor kërkoj prej teje që

këtë ta bësh. Ndërsa pyetja e dytë është, në projektet e vitit 2021 për drejtorin e Shërbimeve Publike ka qenë në projekt trotuari Uçë, tash nuk e shoh, ndërsa kërkojë nga drejtori që të gjejë mjete të ndryshme hapësirë, dhe të futet ky projekt për trotuar që është një projekt jetik për qytetarët sidomos për fëmijët të cilët vijnë mësimin në atë shkollë por që t'i shtohet edhe trotuari Rakosh-Uçë dhe të lidhet e të kryhet një punë tamam siç duhet. Faleminderit!

Kryetari, këto tash pse po i thuani drejtorit, gabim e keni, futeni ju, kryetari e ka fut.

Naim Behlulaj, propozim konkret është që të futen në listën e projekteve 2021.

Kryetari, unë jam duke folur për burime të sigurta, se kështu nuk ka problem hiç e fusim.

Naim Behlulaj, unë kërkoja edhe sqarim se pse është heq, kur ka qenë, merreni Kornizën Buxhetore shikojeni Qarkoren.

Kryetari, nëse ka qenë mirë është mos me heq, se e përmendi edhe Agroni një.

Naim Behlulaj, kryetar ka qenë, është këtu edhe drejtori, ka qenë në listën e projekteve.

Kryetari, duhet me e pasur një arsye se pse është hequr.

Labinot Alijaj, nëse kishte pasur mundësi i kisha jap dy propozime, veç të figurojnë aty e mos të thotë drejtori kodet buxhetore janë ose nuk janë, se po na duhen kodet buxhetore, e kështu që kisha kërkuar nëse bën dy propozime për vitin 2021. E kisha propozuar kubëzimin e rrugës "2 Korriku" që është këtu në lagjen Berati poshtë rrugës 'Uçk', edhe kubëzimin e trotuarit në lagjen të ish Standardi rruga "Hajzer Hajzeraj" këtë trotuar aty kishte me qenë mirë se kurrë në atë lagje nuk është investuar asgjë. Faleminderit!

Kryetari, i ke propozimet me vend Lab, po pajtohem.

Labinot Aliaj, shpesh Kryetar po pajtohesh por po më lë në gjysmë. Faleminderit!

Hysni Maxharraj, t'i sqarojmë propozimet, secilin propozim që bëni, prej mjeteve të sigurta, duhet të bëni propozimin se cili projekt të hiqet nga lista. Nëse e ke bërë propozimin që të jetë nga burime të tjera të financimit në rregull, mirëpo nëse e ke bërë propozimin që të futet prej burimeve të sigurta të financimit duhet me e propozuar një projekt që është në listë me e larguar edhe me e vendos këtë propozim.

Kryesuesi, edhe Naim Behlulaj e pati një propozim.

Hysni Maxharraj, edhe atë me drejtorin e Kulturës do ta rregullojmë atë lëshimin teknik. Jo me e heq jo.

Kryesuesi, mirë pra ato mbesin nga burimet e tjera këto dy propozime. Agron Avdijaj e ka kërkuar fjalën.

Agron Avdijaj, se di tash me të vërtetë prej kujt me e heq e me e qit tjetërkund, është dilemë, edhe veç me e qit le të figurojnë aty si emra por janë që sa e po transferohen. Mirëpo ky buxheti i përgjithshëm kur po del, a janë të mbledhura edhe këto evidentimet p.sh gjipat në dy vende e projekti tjetër që e përmendi Labi në dy vende një dy a tri që janë të identifikuara në dy vende, si është kjo kur mbledhet atje? Është mirë me e na sqaruar.

Hysni Maxharraj, thashë ato janë një në një vend, dhe një në tjetër vend, d.m.th. veç përshkrimi se shuma është në rregull te gjipat. E ato që përmendi të kulturës ajo është prej burimeve tjera të financimit.

Kryetari, dëgjoni tash, e kemi shpjeguar 100 herë këtë, shpesh i kemi qit projektet prej burimeve të tjera, nuk i ka paret për skaj aty hiç. Është problem se nganjëherë çdo donator po na kërkon neve hapur. Mirëpo ju a keni projekte strategjike, në Korniza në plane dy-tri vjeçare lumi që i kemi nëse nuk i ke tash po hezitojnë nganjëherë kanë dalë pa qenë hiç se janë krijuar rrethana të tilla, ndoshta shumë prej tyre, kjo lumi me 100 mijë euro apo rruga transit nuk mund të bëhet. Ne qesim diçka në tabakë, edhe ata edhe bëhem bashkë edhe del edhe donatori tretë se ndryshe nuk mund të realizohet duhet ta keni parasysh 2 milion e 300 mijë euro janë investime kapitale çka me bë me to, ajo është ideja, nganjëherë nuk ndez, ndodhë vijnë e marrin e thonë jo nuk keni nevojë se po e marrim ne krejt, ato mandej transferohen

duhet me qenë pak më fleksibil se ndryshe nuk mundesh me qenë të shtrënguar dhe strikt.

Kryesuesi, faleminderit Kryetar! Ne edhe gjatë vitit po kemi rishikime, ato ndërrojnë. Urdhëro Arben.

Arben Kabashi, unë desha me u lidh me këtë të fundit të Kryetarit, veç unë i kam propozime mbi 2 milion euro sa për informacion. Unë desha me u ndal te kjo se me pëlqeu, te projektet strategjike, te burimi i financimit ose te burimet tjera të financimit, që mundemi me gjet donacione tjera, qoftë prej granteve qeveritare, qoftë prej Fondit Monetar Ndërkombëtar, që nganjëherë Komunat, nuk kanë projekte të gatshme që me pasur mundësi me aplikuar e me nxjerr projekte që me mundur me e realizuar atë investim që vjen prej jashtë. Unë dua me u lidh edhe me çka u fol me herët i përcjella debatet e këshilltarëve komunal, Gurrakoci si qendër urbane, dua me u lidh me këtë pjesën time personalisht që unë vij nga ai lokalitet, edhe gjithmonë edhe prej Kuvendit ndoshta, nuk kam qenë lokalist, gjithmonë i kam përfshirë, qoftë me propozime, qoftë me ide, qoftë me diçka që e ka prek çdo qytetar. Kur jemi te propozimet për zhvillim ekonomik, këtu kisha pas dëshirë me u ndal, e para ka të bëjë që shpërndarjen unë gjithmonë e kam pas vërejtjen që shpërndarjen drejtorët nuk e kanë bërë në mënyrë adekuate që sjell zhvillimi ekonomik. Kur janë marrë ata ekspertët dhe e pardje, e mbrëmë, herë me dhjetë e herë me pesë, pothuajse të gjitha lagjeve të Gurrakocit, duke përfshirë prej lagjes atje Osmanaj' besa edhe disa në fshat të kryesuesit të kuvendit, e deri këtu lartë mbi lagjen 'Podrimaj' i kam marrë shumë propozime që e kapin shumë mbi 2 milion euro, por kjo nuk do të thotë që ne mundemi me i fut ose bie në at kurthin që në këtë rast që unë mundem me e propozuar me e heq një projekt e me e fut tjetrin, por jo nuk dëshirojë me ra në atë pozitë e me më thënë dikush nesër ma ke hequr projektin e fute tjetrin i more votat si more votat. Po thjeshtë dua me i propozuar disa propozime që janë zhvillimore për qendrën urbane të Gurrakocit me rrethinë. E para burimi i financimit, e para mua nuk është duke më interesuar, është problem edhe i Komunës se ka e gjen burimin e financimit, e para kisha kërkuar destinimin e pronave komunale në Gurrakoc, për mi jap zgjidhje qoftë të shfrytëzohet partneriteti publik-privat që është e vetmja mundësi me dalë prej krizës që me u hapur biznese të reja por thjeshtë edhe me u punësuar njerëz. Kisha kërkuar dy propozime, e para është: ndërtimi i rreth rrotullimit në qendër të Gurrakocit që është rruga për Istog, që shumë sipas një eksperti që është shumë i mirë e kap shumë 100 mijë euro, po ashtu edhe në qendër të Gurrakocit në hyrje rrugës për Klinë dhe për Pejë dhe rrugës për Mitrovicë tjetri rreth edhe ai 100 mijë euro, pra dy propozime që kapin shumë 200 mijë euro, këtu kemi të bëjmë edhe me siguri. Propozimi tjetër është hapja dhe ndërtimi i tregut të gjelbër 80 mijë euro. Ndërtimi i shtëpisë në Gurrakoc, të jemi të qartë jemi duke folur veç për qendrën urbane të Gurrakocit, e ceka në

fillim që nuk kam qenë asnjëherë lokalist, por kësaj radhe dua me qenë lokalist edhe ato propozime që i kanë dhënë ata ekspertë, shumica prej tyre janë ekspertë që punojnë në Komuna tjera, edhe kryesisht në kryeqytet në Prishtinë. Ndërtimi i shtëpisë së kulturës me hapësira në shumën prej 250 mijë euro. Ndërtimin e një hapësire për vendosjen e kioskave dhe largimin e atyre ekzistuese 50 mijë euro. Ndërtimin e shtegut të biçikletave dhe trotuarit krahas prej qendrës deri te ura e Istogut që e quajmë ne lumi Istog, dhe për gjatë tij deri te penda e dytë që e kap deri në fshatin Zallq çmimi 350 mijë euro. Pastrimi që e përmendi Kryetari se shumë defekte janë ne çka e shohim me sy, pastrimi i lumit Istog, tash po bëhem lokalist në kuptimin por po i përmendi ato propozime që i kanë dhënë. Pastrimi i lumit Istog prej ure deri në fshatin Zallq 250 mijë euro. Betonimi i kanalit për toka bujqësore në lagjen 'Osmanaj' që e kap prej 'Osmanaj' deri në Drejë tu e përfshirë edhe Zallqin 280 mijë euro, kushton edhe më lirë varet prej ofertave. Kërkesë e qendrës urbane të Gurrakocit është që ju e dini frekuentimin e madh në sektorin e bujqësisë e zhvillojnë nëpër bieshkë, pra kërkojnë sot janë mbi 300 krerë lopë në bieshkën e Jerebisë që nuk kanë ujë të pijes, pra hapjen e 5 puseve që nuk kushton 38 mijë euro, kryesisht ju e dini që qendra urbane e Gurrakocit sot sipas një statistike në bazë të komisionit të blegtove që është atje i kanë mbi 6 mijë krerë lopë që e zhvillojnë më së shumti atë lëmi, po kryesisht sezoneve nuk e shfrytëzojnë bieshkën për shkak të mungesës së ujit të pijes. Kur jemi te shkolla e kemi ne sallën po nuk di një përgjigje nuk e kam marrë ende d.m.th salla sportive në kuadër të shkollës "Martin Camaj" ka mbet përgjysmë nuk e di ku është defekti, nuk kam marrë përgjigje asnjëherë, nuk e di kisha kërkuar pak edhe nga Drejtori i Arsimit me dhënë një përgjigje për sallën e sportit, po ashtu kisha kërkuar 10 mijë euro me i ndarë për bibliotekën shkollore, 5 mijë euro furnizim me libra pothuajse të dy niveleve, qoftë nivelit teknik qoftë atë të klasave të cikleve të ulëta, që i bie prej klasës së parë deri në të tetën me furnizim edhe do një rinovim, 5 mijë euro e kanë paraparë. Po ashtu e kanë paraparë të hapet në kuadër të shkollës " Martin Camaj" të jetë edhe një klasë që të krijohen kushtet për mbarëvajtjen e fëmijëve handikap , që e përfshinë shumica e fshatrave që e frekuentojnë shkollën e Gurrakocit pra të jetë një klasë e veçantë kujdes më i madh, në kuadër të shkollës " Martin Camaj" . Edhe betonimi i kanalit të Jazit të Gogës' që e frekuentojnë shumë herë mbi qindra hektarë që ujiten, sherri i atij kanali nuk ujiten. Janë propozime të pakta që i kanë propozuar unë i kam marrë ato që janë pak më të rëndësishme por kryesisht z. Kryetar tu kisha drejtuar ty që edhe ato vendime që janë marrë më herët për rrënimin e objekteve të vjetra në përgjithësi, mi le të mua patriotizmat false kush çka flet andej, është koha e investimeve më shumë në qendrën urbane të Gurrakocit, pra të merret një vendim inspektorati që objektet e vjetra të rrënohen totalisht dhe si rrugëzgjdhje të jetë hapja e bizneseve të reja. Faleminderit!

Kryetari, Arben lumin që e the ka projekte, projekti i lumit ekziston. Tash është bërë para një muaji ka përfunduar, kur them lumi i Istogut unë po kuptojë prej burimit deri atje mos ma ndajë nëpër faza d.m.th i përmenda Llugat atje e përmenda

Cerrcën, nuk e përmenda Gurrakocin po projekti është aty, pastrimi dhe hapja e lumit një fazë, diku sa di unë në tërësi është një shumë e parallogarit 700-800 mijë euro është kanalizimi kolektori kryesor që vjen deri në Zallq atje është faza tjetër dhe përsëri lumit është rruga që nënkupton stazë të biçikletave të udhëtarëve në mënyrë që edhe mirëmbahet lumi edhe mirëmbahet krejt ambienti aty, ky është ai projekti, se ai është projekt voluminoz, unë krejt jam duke të folur duhet me u pastruar krejt e del atje se aty veç ka filluar një lloj pastrimi, do të fillojë shumë shpejt se krejt ideja është kjo faza e dytë që po mundohem me e nxjerrë të kreditimit si fazën e dytë të ujësjellësit, që është në përfundim, është çështja e kanalizimit kolektorëve kryesor, që do të mblidhen buzë lumenjve e përrenjve edhe shkojnë në pikën më të ulët që është në kufirin e Istogut me Klinë atje në zonën e Zallqit nga Dreja, ajo është ideja, ato janë të projektuara, dizajni është bërë, janë bërë edhe matjet, mirëpo kërkohen edhe financa. Pastaj kemi ardhur në fazën tjetër të stacionit të pastrimeve të ujerave të zeza, një ditë kam biseduar me Gazin, kam biseduar edhe me të Klinës, është ideja me e bërë të përbashkët, Peja e ka të konceptuar në fshatin Terstenik, edhe ne duhet me të be variante mundësisht donatori me qenë i perbasniket me u be edhe Istogu edhe Peja në një pikë. Aty duhet me ndërlidh edhe lumin Drin, kjo është një fazë e ardhshme, që në të vërtetë janë çështje të milionave, kërkesat e juaja janë krejt reale, krejt janë të mira ,por këto tash mos na thuaj me i fut bash lehtë ku ma përmendi një bibliotekë 10 mijë euro mandej kalon në projektin 700-800 mijë euro, këto janë më shumë strategjike këto i keni plane strategjike, janë disa gjëra që nuk është se ne nuk jemi duke menduar për këtë punë. Tash ajo çështja e rreth rrotullimit, që po e përmend ti unë nuk pajtohem fort me ty, dëgjo unë për çdo ditë i bie nga kjo anë bile goxha mirë janë të bëra ato si kanë mundur me qenë, mos harro që në rrugën e regionale që lidhet edhe me koncepte të Ministrisë, tash ata ekspert të komunave tjera unë nuk e di, nëse janë aq të mirë silli.

Kryesuesi, mirë vazhdojmë më tutje, po besoj që është e qartë edhe këtë që e the unë veç po shtoj Arben ky kanal është i paraparë nga burimet ' Osmanaj- Drejë'.

Kryetari, pastrimi i kanalit të Drejës është i paraparë, edhe marrëveshjen me drejtorin e kemi me e bërë komplet.

Kryesuesi, dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Jo. Atëherë mund ta përmbylлим. Drejtor disa projekte që u përmenden, këto që përfshihen.

Agron Avdijaj, disa sqarime me i bërë se pse janë hequr disa projekte. Ndoshta për Sinajë pat me jap një sqarim.

Kryesuesi, urdhëro, drejtori i Shërbimeve Publike Enver Rugova e ka fjalën.

Enver Rugova, sa i përket këtij kanalizimi, ja kom borxh edhe Labinotit, se shumë herë e ka ngrit çështjen e kanalizimit, në Shushicë të Ulët, bash drejtorja jonë inxhinierët në bashkëpunim me kompaninë kontraktuese le të është ky lajm edhe për opinion jo vetëm për ju të gjithëve këtu. Është duke e hartuar projektin në baza pak më të gjëra, d.m.th. po biem në fjalët e kryetarit që edhe atë ndoshta në vitin 2022 do të jetë ky projekt, ne do t'i drejtohem Ministrisë së është shumë i kushtueshëm. Fshatrat si Moistir, Shushicë, Shushicë e Ulët, Veriq, Kovragë, Dubravë, dhe një pjesë e Gurakocit që shkon anej ka Bllagaqi dhe kjo pjesa këndej sivjet jemi duke i planifikuar derdhjet, sepse për kanalizime problemi më i madh janë derdhjet. Ne i planifikojmë të jenë derdhjet te lumi, që pastaj siç e tha edhe Kryetari me ato projekte që janë më të kushtueshme më të mëdha t'i mbledhim dhe të shkojmë te impianti ku e caktojmë atje më Komunën e Pejës sepse kur të janë dytri komuna të përbashkëta edhe vlera e projektit faktikisht për Komunën tonë do të ishte me e kopsime, kështu që jemi në baza pak më të gjëra që t'i përfshijmë te gjithë sepse p.sh merre prej Sinaje e qite në Dushkajë, aty pastaj i kemi për çdo ditë grupet e qytetarëve që vijnë në zyre, edhe kanë të drejtë kryesisht në temperatura të larta, ma hiqni prej arës, prej lagjes, kemi mjaftë kësi lloj problemesh. Sa i përket deponisë në Tyqep ki drejtë brenda shumë që e kemi aty do ta rregullojmë këtë sepse pa deponi në Tyqep asnjë prej këtyre projekteve nuk na vyejnë fare sepse është çështje e mbeturinave dhe ato duhet me i hedhë. Te trotuari në Uçë, këto nuk janë heq Naim, as nuk heqim projekte, ka qenë i propozuar me burimeve të sigurta por siç e tha Kryetari me vazhdimin e kohës vitin e ardhshëm ka prej bartjeve, rishikimi, donator të ndryshëm, kështu që unë besoj shumë që vitin e ardhshëm do të kryhet. Faleminderit!

Kryesuesi, faleminderit shumë Drejtor! Po mendoj që e shtjelluam mjaftë. A ke ndonjë propozim konkret. Mendoj që e more përgjigjen.

Hysni Maxharraj, këto vërejtjet e vogla teknike do të rregullohen, propozimet që janë bërë do të vendosen prej burimeve tjera të financimit. Faleminderit!

Agron Avdijaj, lidhur me sqarimet e drejtorit, shumë herë po na thuhet kur po hiqet një projekt, me një lloj arsyesimi se fillimisht duhet me u bë diçka tjetër për me u realizuar ai. Tash pyetja ime është pse e keni fut atëherë? Nuk është vetëm për këtë rast. Në shumë raste po hiqet te kanalizimet sidomos, jo se tash po planifikohet me shtruar rrugën, e kur te shtrojmë rrugën, d.m.th. ose po bëni keq planifikim.

Kryesuesi, edhe ne po ja japim krahun, se po i votojmë këtu. Këtu pak problem.

Agron Avdiqaj, e unë për atë arsye kësaj radhe buxhetin nuk mundem me e votuar. Nuk mundem me e votuar pikërisht për këtë se po na përsëriten gjërat.

Kryetari, je duke kërkuar arsye mos me e votuar a?

Agron Avdiqaj, ka arsye shumë, nëse mendon se nuk janë arsye këto, është diçka tjetër.

Kryesuesi, mirë po ajo çka e tha dikush aty, drejtori po më duket, me ja asfaltuar rrugën e mos me ja bo kanalizimin është e arsyeshme, bën me i ndërruar, ma mirë kanalizim pastaj rrugën se me prish rrugë.

Atëherë mund të konstatojmë se në sallë jemi 23 anëtarë të Kuvendit, e debatuar, e shtjelluar, Draft Buxhetin Komunal për vitin 2021-2023 me propozimet që u dhanë edhe këto shtesë. Atëherë kush është që të miratohet ky Draft Buxhet i propozuar i ardhur në Kuvend pas të gjitha procedurave të parapara deri më tani. Kush është për?

Labiot Aliaj, a me propozime tona a pa propozime tona?

Kryesuesi, u morëm vesh për ato propozime, ato që nuk patën burim, por disa prej tyre veç ishin. Nuk mundemi me e lënë betonimin e kanalit kur është. Vazhdojmë kush është që të miratohet?

Naim Imeraj, me a pa propozime shtesë?

Kryesuesi, me propozime shtesë, tha drejtori me burime shtesë mirëpo nuk patëm, veç një ishte që është ndërruar me burime të sigurta diçka, nuk pat diçka që duhet të hiqet ndonjë projekt. Kush është për?

Konstatojmë që miratohet Projekt-Buxheti Komunal i Komunës së Istogut për vitin 2021-2023 me 20 vota për, 2 kundër, dhe 1 abstenim.

Shqyrtimi i pikës së 7.

Kryesuesi, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, Marrja e vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave dhe komisionit për ankesa për vitin kalendarik

2020-2021. Të nderuar anëtarë të Kuvendit, bazuar në Rregulloren për ndarjen e bursave, në komisionin për ndarjen e bursave parashihen të jenë 5 anëtarë, ku 3 anëtarë i përcakton Kuvendi, një nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile. Prandaj unë sa për informim besojë që e dini po e përsëris, në komisionin për ndarjen e bursave kanë qenë: Hajrush Shoshi nga ekzekutivi, Valbona Demaj nga LDK, Nexhmedin Balaj, nga AAK, dhe Labinot Aliaj nga PDK. Ju e keni kryer detyrën e juaj vitin e kaluar, meqë kërkohet që këto komisione të jenë vetëm për një afat, unë kërkojë nga ju propozimet për komisionin e ardhshëm, në këtë strukturë çfarë e keni pasur, një nga PDK, një nga AAK dhe një nga LDK. Atëherë nga LDK-ja a kemi ndonjë propozim. Zenel Shatri është lajmëruar.

Zenel Shatri, ne propozojmë nga LDK-ja për komisionin për ndarjen e bursave të jetë Riza Dreshaj.

Kryesuesi, mirë Riza ka qenë anëtar në komisionin për ankesa, tash po propozohet në komisionin për ndarjen e bursave.

Nga AAK, a kemi ndonjë propozim?

Naim Imeraj, Nexhi po priton me u marrë me ankesa po dëshiron me kërkesa. Propozimi nga AAK-ja Nexhmedin Balaj.

Kryesuesi, Nexhmedini ka qenë në komisionin për ndarjen e bursave, më nuk mund të jetë.

Naim Imeraj, çka e përjashton që ai me qenë prapë. Kështu që propozimi është Nexhmedin Balaj.

Kryetari, mos kërko diçka nga unë se unë nuk jam në komision.

Naim Imeraj, propozimi i grupit jo formal i AAK-së Nexhmedin Balaj për anëtar të komisionit për ndarjen e bursave.

Kryesuesi, për ndarjen e bursave ka qenë prandaj nuk mund të jetë.

Naim Imeraj, në bazë të kujt?

Kryesuesi, në bazë të Rregullores. Mund të caktohet vetëm për një ndarje.

Naim Imeraj, nëse është në kundërshtim propozimi me Rregulloren atëherë ne e bëjmë propozimin tjetër.

Kryesuesi, në Rregullore është se komisioni formohet për çdo vit. Nuk precizon anëtarin, ne duhet të marrim vendim për një komision, nuk mund të vazhdojë punën komisioni paraprak, nuk d.m.th që personi që ka qenë mos të jetë prapë, desha me treguar që Nexhmedini ka qenë në komision.

Naim Imeraj temë e shterur, propozimi jonë si grup jo formal për komisionin që vien per vitin 2020-2021 është Nexhmedin Baiaj.

Kryesuesi, nga radhët e PDK-së, a ka ndonjë propozim?

Labinot Aliaj, faleminderit Kryesues! Së pari si ish-anëtar i komisionit për dy vite me radhë dua t'i falënderojë kolegët për bashkëpunimin, edhe që besojë për punën e mirë që e kemi bërë, për këto 20 vitet pas luftës këto dy vitet e fundit janë shembull për zgjedhjen e bursave, në emër të PDK-së e propozojë Arben Kabashin që të jetë tani e tutje në komisionin e ri, te LDK-ja kryesues e bën femër, dhe kisha pasur një vërejtje që nga shoqëria civile mos të jetë si herën e kaluar mos të jetë drejtoreshë e një shkolle, por të jetë tamam e shoqërisë civile. Herën e kaluar kemi pas drejtoreshë të shkollës të Vrellës, kështu që besojë se nuk do të ishte në rregull, kështu që kërkoj që të jetë tamam nga shoqëria civile. Faleminderit!

Kryesuesi, mirëpo ne përkatësinë gjinore nuk po e përmbushim këtu. A mund të bëjmë ndonjë kompromis që të kem një të gjinisë femërore një anëtare të Kuvendit.

Zenel Shatri, qe në komisionin për ankesa po e bëjmë femër.

Labinot Aliaj, ne i kemi lutur së pari dy profesoreshat, po për shkak të kohës dhe angazhimeve nuk po pranojnë të jenë anëtare. Ne me i detyruar nuk po mundemi.

Zenel Shatri, nga LDK-ja herën e kaluar e kemi ndërruar mashkull e kemi bërë femër për komision për ndarjen e bursave.

Riza Dreshaj, ju përshëndes të gjithëve! Edhe herën e kaluar këtë problem e kemi pasur, jam propozuar për komision për ndarjen e bursave jam tërheq edhe kam kaluar në komision për ankesa, edhe tash pranojë të njëjtën gjë, e kam ditur që në fillim se kemi me hasur në këtë problem. Unë mundem me u tërheq prapë por me një kusht që mos me qenë as në komision të ankesave. Unë tërhiqem propozojeni kë të doni.

Kryetari, a e dëgjuat fjalinë, Labinoti tha që kurrë më mirë se dy vitet e fundit nuk janë ndarë, a di pse janë ndarë mirë? Faktikisht kurrë më keq nuk janë ndarë se dy vitet e fundit po ju garantojë për një arsye se janë marr vesh ndërmjet vete, ma jap ti mua një, unë ty një , për këtë arsye ka dalë mirë. Prandaj përzierje bëni sa të doni se del mirë. Nuk është Lab ashtu.

Labinot Aliaj, Kryetar po më vjen keq por nuk mundem pa reaguat këtu. Për arsye se ne e kemi një Rregullore në të cilën jemi bazuar, Rregullore e votuar këtu në Kuvend komunal, edhe vetëm një përfitues i bursës le të dal që është marrë dikush vesh me dikë unë japi llogari. Të gjitha janë shkuar në bazë të dokumentacionit që e kanë ofruar, nuk është e drejtë me thënë që na kanë bërë se këtu janë duke na parë edhe qytetarët edhe mendojnë se ashtu është, unë nuk e di një anëtarë i komisionit që e ka pas dikë edhe ka thënë këtu dua me ma kaluar, edhe nuk kishte me ndodhë ajo kurrë, ka ndodhë në bazë të Rregullores në bazë të poenëve që i kanë marrë.

Kryetari, Lab është ajo çka mendojë pavarësisht a shikojnë qytetarët a jo.

Labinot Alijaj, Kryetar unë e di që edhe ti e di që nuk është ashtu.

Kryetari, jo Lab unë e di si është, ju kisha lut bëni komisionet, jepni zor kapni e mos i lëni njerëzit se që 1 vit i keni shtyrë njerëzit, a din sa njeri më ka ardhur te dera nuk e qitet bursën hala.

Labinot Aliaj, vërejtje ka Kryesues, po ka sepse një Rregullore që e kemi votuar ne këtu nuk është shikuar mirë tu ec në procedura, tash ne jemi bazuar në bazë të Rregullores, nuk mundemi me ja jap dikujt bursën kur nuk i ka sjell dokumentet nuk e ka sjell dokumentacionin e nevojshëm, nuk mundem me ja jap bursën në qoftë ai edhe vëllai im. Edhe diçka, te pagesat e kam thënë edhe në mbledhjen e kaluar, një shtyrje mes zyrtarëve financiar na ka dërguar deri te një vit mos pagesë. Kur drejtori Hysni Maxharraj, me drejtorin Hajrush Shoshi kërkonin që shuma prej 10 mijë eurove të shkon për pagesë të bursave me propozim të kolegut Shatri, janë

shkuar për trotuar nga Gurrakoci në Tomoc, ajo shumë për ata ka mbetur pa u paguar se nuk ka pasur fonde, mos te mbet faji te ne. Faleminderit!

Kryesuesi, nuk po hymë në ato detaje, se tash kemi diçka tjetër pikë të rendit të ditës.

Zenel Shatri, Qaush mua më është përmend emri. Nuk është ashtu se unë dy herë kam pyet edhe në KPF edhe këtu jam deklaruar, nëse nuk ka pare për bursa, le të shkojnë për bursë, nëse ka pare për bursë le të bëhet trotuari, kështu jam deklaruar dy herë, kështu që nuk është e vërtetë ajo që unë kam insistuar me marrë me çdo kusht, por është deklaruar edhe zyrtari kryesor financiar, Osmani që ka para për bursë. Për këtë arsye.

Kryesuesi, është e vërtetë kështu ka qenë nuk është nevoja me i përmend Lab emrin. Kështu edhe diçka nëse i lëmë tre anëtarët e Kuvendit e nuk kemi gjini femërore vendimin Ministria e MAPL-së na e kthen mbrapshtë për shkak të gjinisë, këtë dijeni nuk mund t'i lejoj. Unë po kërkoj ndonjëri prej këtyre të treve të propozuarave që të ndërrohet dhe të jetë një e gjinisë femërore. Nëse nuk dëshironi, e lëmë, edhe Ministria na e kthen.

Agron Avdijaj, unë desha me e lidhur me atë që unë jam për që me pas përfshirje të grave apo vajzave më shumë në këto komisione, sepse me thënë të drejtën besoj më shumë se janë më të drejta kështu si natyrë, e kam një përshtypje të tillë, ndoshta edhe jam i gabuar por e kam një përshtypje të tillë. Nëse bazohemi në raportin e treguesve të përformancës, pikërisht te përfshirja e grave në pozita vendimmarrëse komuna e Istogut renditet goxha poshtë edhe kishte me qenë mirë edhe ju bëj thirrje edhe kolegeve mos të hezitojnë t'i propozojnë.

Kryesuesi, nuk do të dalim serioz në qoftë se edhe nuk po e respektojmë gjininë por edhe në të njëjtën kohë i njëjti person dy-tri mandate si anëtarë i komisionit. Edhe kjo nuk është në rregull, kur mund të ndërrohet, edhe për atë arsye ka mbetur me e përsëritur. E juaja është me vendosur.

Labinot Aliaj, Kryesues LDK-ja kryesuesin e komisionit e ka mashkull le të dërgon tjetrin femër.

Kryesuesi, urdhëro Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj, përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket ndarjes së bursave parregullsi kanë pasur, ato parregullsi sigurisht i janë dedikuar atyre që kanë punuar në atë drejtim. Por sipas meje çdo kush e ka një lloj pjese, unë mendoj që ndoshta Rregullorja duhet me u korrigjuar, për vet faktin që rezultatet që ne i kemi parë kanë përfituar bursa nxënësit që dy prindërit i ka pasur në arsim, dhe nga ana tjetër ka mbetur dikush jashtë liste që nuk ka pasur ka me e marrë asnjë cent. Për këtë shkak kisha kërkuar d.m.th mirëkuptim, rishikim të asaj Rregulloreje në mënyrë që mos me i bërë gabimet e njëjta si vitin e kaluar. Faleminderit!

Kryesuesi, tash ju dhatë një propozim krejt tjetër. Tash ne jemi në këtë pikë për me e formuar komisionin, e ju po e propozoni me e ndryshuar Rregulloren.

Ajshe Metaj, unë veç sqarova që herën e kaluar bursat janë ndarë keq Kryesues, në bazë të listës janë ndarë keq.

Kryesuesi, nëse na propozon me e ndryshuar Rregulloren thuaj po, e fusim në votim. Pajtohen mirë nuk pajtohen vazhdojmë më tutje.

Zenel Shatri, mua ma merr mendja që propozimi për ndryshimin e Rregullores është me vend, po për sivjet është e pavlefshme, se nuk kemi kohë ne me e bërë ndryshimin e Rregullores, plus asaj me ja u ndarë bursat, sivjet shkon me Rregullore të vjetër, nuk ka shans me ndërruar, veç nëse dëshiron me lënë deri në vitin tjetër. Në të ardhmen po, a tash nuk jam për me e ndryshuar Rregulloren.

Kryesuesi, për të ardhmen po e dëshiron atë propozim a po?

Ajshe Metaj, jo Kryesues unë nuk e di a ka kohë a nuk ka, megjithatë unë e kam parë që diçka nuk ka qenë në rregull nga ato që unë i kam parë, tash fajtori faji është jetim, por unë po mendojë që mos prapë Rregullorja, nëse nuk ka mundësi me u korrigjuar Rregullorja, atëherë le të përsëriten gabimet qysh janë bërë herën e kaluar, ama unë jam befasuar dy prindërit i ka pas e ka përfituar bursë, nuk kam asgjë kundër askujt.

Kryetari, Ajshe nuk ka problem, nuk po kam qejf me keqkuptuar, se ndoshta pak pa vend reagoval, unë nuk po them që janë bërë gabime katastrofike, por nuk pajtohem as me faktin që tash janë ndarë më mirë se përpara se po ju garantojë që jo, tash ju gabimet po i nxirrni prej Rregullores, mirë unë pajtohem, por në bazë të asaj Rregulloreje sa ma pak gabime është mirë me bërë asgjë tjetër, nuk është mirë me bërë

gabime të mëdha, e unë jam duke folur për këto gabime që janë bërë jashtë Rregullores, këtë unë mundem me ja u argumentuar kur të doni.

Labinot Aliaj, unë kisha pas dëshirë me ma argumentuar.

Kryetari, ka marrë fund ajo punë Lab, bëni më mirë se herën tjetër.

Labinot Aliaj, Rregullorja është nënshkruar këtu, në bazë të Rregullores as një studenti që i ka të dy prindërit në punë nuk i ndalohet me fituar bursën.

Kryesuesi, nuk jemi duke folur tash për ato, a do e formojmë komisionin a jo.

Urdhëro Valbona Demaj.

Valbona Demaj, edhe unë për këtë çështje e pata, d.m.th. kanë qenë tri pika, ka qenë kriteri, ndarja e saj, nota mesatare.

Kryesuesi, Valbonë kërkoj falje, jemi te formimi i komisionit i keni propozuar 3 anëtarë, mundësi për ndërrim për shkak të përkatësisë gjinore nuk po ka askush prej jush nuk po tërhiqet, nuk po ka propozim tjetër.

Kush është që këta 3 anëtarë të jenë anëtarë të komisionit për ndarjen e bursave, kush është për?

Naim Imeraj, Kryesues nëse është në kundërshtim me ligjin nuk është mirë me e fut në votim.

Kryesuesi, të lutem atëherë Naim, unë nuk mundem me bërë zgjidhje.

Naim Imeraj, nuk jemi të përgatitur, edhe me e përmbyllur këtë rend të ditës.

Kryesuesi, ti po e propozon kandidatin që ka qenë në komision, nuk po pranon me e ndryshuar, nuk po pranon me e sjell të gjinisë femërore.

Naim Imeraj, kërkesa juaj ndaj nesh është kundërligjore, se po vjen tek një vendim që ne po e dimë që ka me u kthyer, atëherë mos e fut në votim diçka që e di që nuk

është në rregull, më mirë është me e shtyrë këtë pikë të rendit të ditës për një mbledhje të ardhshme, se me shkuar në Ministri e me u kthyer, e ne çka po bëjmë asgjë nuk po bëjmë.

Kryesuesi, unë nuk mundem, ju po e propozoni.

Naim Imeraj, mirë, nëse po më drejtolesh me atë që kam bërë diçka jo ligjore gabim e ke.

Kryesuesi, ne duhet ta formojmë komisionin.

Naim Imeraj, e drejtë e jona është me propozuar, çelësin duhet së bashku me e pasur.

Kryesuesi, Zenel a po dëshiron me na gjetur zgjidhje.

Zenel Shatri, po dua me e lut Naim, jo për diçka kështu, ne vjet kemi bërë kompromis e kemi hequr mashkull e kemi qit femër, e kisha lutur grupin parlamentar të AAK-së që ta bëj këtë kompromis, nëse ka mundësi dhe të bëhet struktura gjinore e cila po kërkohet, nëse ka mundësi, nëse nuk ka mundësi nëse jo nuk e kemi problem atë punë, shkon kështu por kthehet, ose duhet me e lënë për tjetër herë.

Naim Imeraj, me pas qenë unë e me më lut me heq dorë krejt prej atij, kisha thënë po nuk ka problem, ka ndodhë që e kemi hedhur edhe ne grupet tjera me vet dëshirë dhe me qëllim të mirë, por kemi marrëveshje që është kjo që e kemi deklaruar kërkoj falje Doktor, që këtë kërkesë ta kthejë tjetër herë.

Kryesuesi, e nga PDK-ja?

Arben Kabashi, që unë po ta jap versionin, çdo herë kur ta sjellësh kërkesën diskutoje më përpara, edhe sjelle të përfunduar këtë gjë, pse po them kështu, ti e ke një çelës, çelësit duhet me ju përmbajtur nuk e kap askund ne partia e katërt me kap të gjinisë femërore duhet me e kuptuar këtë gjë, i pari kryesuesi është drejtori, i dyti i bie partisë më të madhe parlamentare që është LDK-ja, prapë të gjinisë mashkullore, tani e treta prapë e gjinisë mashkullore, kupto pak, prej të treve zgjedh njërin cilin duash çelësin e ki edhe u krye puna, ti ke mundur në parti p.sh në LDK, i

takon gjinisë femërore kaq, edhe e kishe bërë të kryer, ndoshta PDK-ja ka qenë më reale prej te gjitha partitë pse? Dy komisione të përhershme të nivelit lokal dyja i kemi dërguar anëtare të gjinisë femërore, edhe çelësi është në ato dy komisione të përhershme.

Kryetari, po veç Arben është një çështje këtu, dëgjo se e ke edhe Mirushen edhe Ajshen, i ki dy profesoresha shumë vjeçare.

Kryesuesi, ato nuk po thonë asgjë që janë deklaruar se nuk po dëshirojnë.

Labinot Aliaj, Kryesues nuk po pranojnë se për ne nuk kishte me pas problem, asnjëra nuk janë lajmëruar të dy anëtarët tona i kemi lutur, nuk po dëshirojnë.

Zenel Shatri, qe Valbonën, ose Njomzën, po Njomzën po e propozojmë.

Kryesuesi, anëtarët e komisionit për ndarjen e bursave janë propozuar, Njomza Ademaj, Nexhmedin Balaj dhe Arben Kabashi, kush është për?

Konstatojmë që në mënyrë unanime votohet komisioni për ndarjen e bursave.

Kryesuesi, a ka propozime për komisionin për ankesa.
Agron a je i interesuar me pasur kandidatë?

Agron Avdijaj, unë propozojë Lavdije Bujupin.

Kryesuesi, Zenel Shatri urdhëro?

Zenel Shatri, unë propozojë dëshirojmë me i bërë dy femra, dhe propozojë Edona Lubeniqi.

Kryesuesi, nga AAK, kë po e propozoni?

Naim Imeraj, ne e propozojmë Misin Berishën.

Kryesuesi, kush është për që këta anëtarë të jenë anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e bursave?

Konstatojmë që në mënyrë unanime u votua komisioni për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e bursave.

Kryesuesi, sa i përket anëtarëve të tjerë na i sjell emrat ekzekutivi.

Kryetari, për anëtarë të komisionit për shqyrtimin e ankesave, propozohet Drin Sadikaj.

Labinot Aliaj, Kryesues a është e sigurt që bën me qenë kryetar i komisionit jo drejtori i arsimit, sa di unë drejtori i arsimit duhet me qenë kryetar i komisionit për ndarjen e bursave, sqarim po kërkojë.

Kryesuesi, nëse nuk bën e heqim.

Labinot Aliaj, nëse bën ashtu atëherë në rregull.

Kryesuesi, me ekzekutivin flasim për këtë punë. Vazhdojmë më tutje me pikën tjetër të rendit të ditës. Drejtori Lulzim Blakaj e ka bërë një propozim. A do me na u arsyetuar më drejtor, a ka nevojë diçka tjetër.
Urdhëro Naim Imeraj.

Naim Imeraj, sa po e kuptojë unë propozimi edhe pse nuk është formuluar si aktvendim besojë se formulohet nuk është problem, por problemi është kështu, pika e parë që kërkohet me u bërë është që duhet me bërë transfer, ndërsa pika e dytë është rialokim, tash dallimi mes transferit dhe rialokimit besojë që jemi familjarizuar por është një dallim. Te shumat, thotë shumat e mjeteve dhe nuk thotë sa, mirë është me e thënë se në pikën dy ka thënë menjëherë sa, mu po më del se është 8 mijë e 769 euro e 50 cent. Po më intereson prej drejtorit sa është e saktë kjo, edhe te pika dy, kur mbledhet 5 mijëshi edhe këto tri komponentë, nuk po del 11 mijë e 552 po 11 mijë e

489, a ka mundësi pak me i filtruar këto, varësisht se munden me u filtruar edhe më pastaj por vendimi është vendim po na po marrim vendim, ishin dashtë me qenë edhe shifrat e sakta, besojë që e kuptoi drejtori se për çka e kisha fjalën.

Kryesuesi, urdhëro drejtor a mundesh?

Lulzim Blakaj, korrekt është, ky është një propozim mundet me qenë edhe shuma prej kaq 8 mijë e 769 euro prej këtyre projekteve fillimisht si shumë edhe kjo është korrekt ,d.m.th gabim është ajo, shuma është ajo që e thatë edhe ju, 11 mijë e 489 euro, se unë jurist jam me profesion. Kështu nëse me lejoni, pak jam konsultuar me drejtorin e drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe drejtorin e drejtorisë së Shërbimeve Publike për shkak se është projekt i ri ndërtimi i kanalit anësor në lagjen 'Idrizaj' në Lubozhdë, ekziston mundësia që ky projekt mos të miratohet nga niveli qendror d.m.th nga Ministria e Financave. E kemi projektin mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve te asfaltuara, ky është një projekt që po realizohet, veç është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik, edhe në kuadër të përshkrimit të punëve për mirëmbajtjen verore dhe dimërore janë edhe punimi i kanaleve edhe meremetimi i rrugëve, asfaltimi i gypave, d.m.th përmban ato elemente që mundet me u realizuar edhe ky projekt ' ndërtimi i kanalit anësor në lagjen 'Idrizaj'. Ne po e marrim përsipër për obligim bashkë me drejtorin për shërbime publike që këtë projekt pasi që nuk kërkon procedura të tenderimit ta realizojmë menjëherë. Ne jemi konsultuar, është çështje se po e propozojmë, ne mundem me lënë edhe kështu por ekziston mundësia që u konsultuam që mos me u realizuar, por edhe si propozim i tillë me lënë kështu, unë nuk e kam asnjë vërejtje. Por thamë që me u realizuar më shpejt për shkak se ekziston projekti ekzistues mundet me u ekzekutuar. Që jo, atëherë unë jam prapa këtij propozimi.

Kryesuesi, urdhëro Naim!

Naim Imeraj, faleminderit për fjalën Kryesues, para se me e përcaktuar rendin e ditës e kemi marrë një dokument, një draft dokument që nuk është as vendim, e pranuar si të tillë, tash po ne del që ka defekt, të natyrës së pranimi financiar, nuk është korrekt, se me e pas ditur që ky projekt nuk e ka vendin këtu, atëherë është dashtë ne, tash me filluar prej interesit të caktuar, është dashtë që me insistuar që me hy në buxhet, kalojë buxheti u krye ajo punë, tash po del që kjo nuk bën. Këtë version të propozuar e miratojmë, çfarë do versioni tjetër nuk e miratojmë, së paku nuk janë votat e grupit të AAK-së.

Lulzim Blakaj, voto si të duash, unë kam të drejtë me e propozuar, unë qëndroj prapa këtij projekt propozimi që e kam bërë.

Kryesuesi, Hysni a mundesh me na sqaruar diçka më shumë se kemi nevojë të gjithë.

Hysni Maxharraj, kërkesën që e kemi bërë në rishikim të buxhetit për projekte të reja, nuk na u kanë realizuar të gjithë e dinë, veç për këtë që të realizohet më shpejt puna por si të doni.

Zenel Shatri, pse nuk e analizuat më parë e me na treguar.

Kryetari, dëgjo a ka qenë në rishikim ky?

Hysni Maxharraj, jo jo nuk ka qenë në rishikim.

Kryesuesi, në pyetje janë 11 mijë e diçka euro, mirë është me i jap udhë mos me na humb këto mjete e me mbetur pa u realizuar. Është e dobishme për të gjithë. Por duhet të sqarohemi edhe në aspektin ligjor.

Kryetari, një pyetje për drejtorët. Nëse këta e miratojnë e ti nuk mundesh me e realizuar, pse po i vë në lajthitje e nuk ke drejtë me krijuar kod të ri. Shpjegojeni mirë.

Hysni Maxharraj, propozimi është të bëhet një kanal aty në projekt të ri, por mundet me e fut te sanimi që kemi kod të projektit ekzekutues edhe realizohet, këtu është vetëm një ndryshim i vogël.

Kryetari, pse po hyni si me qenë të dyshimtë?.

Hysni Maxharraj, mirëmbajtjen e rrugëve, e kemi prej mallra dhe shërbime në shërbime publike dhe ajo mund të realizohet menjëherë ai propozim rregullimi i atij defekti në asfaltin e lagjes "Idrizaj" ato t'i dërgojmë në këtë projektin tjetër edhe krejt është në rregull.

Naim Imeraj, këtë kombinim nëse e merr dikush përsipër mirë,

Hysni Maxharraj, unë e marrë, kjo është vetëm një ndërrim i vogël, edhe krejt është në rregull. Atë e rregullon Enveri me kontratë që e ka.

Lulzim Blakaj, le të jetë si propozim, që projekti, ndërtimi i kanalit anësor lagjes Idrizaj në Lubozhdë të realizohet nga ky si plotësim i këtij vendimi, në mënyrë që te jetë tamam ekzakt.

Naim Imeraj, formulimin me e bërë në mënyrë që mos me e kthyer ata.

Lulzim Blakaj, dhe le të jetë prej këtij kodi në mënyrë që të kemi sigurinë që po e kërkon, për ekzekutim dhe të obligojmë drejtorin me e ekzekutuar. Edhe kjo shuma 2660.00€ të kalojë në emergjenca.

Kryesuesi, drejtor faleminderit për sqarimin.

Lulzim Blakaj, me propozim vendimin do të njoftoheni të gjithë.

Kryesuesi, atëherë të nderuar anëtarë të Kuvendit besojë që u sqarua kjo çështje dhe mbetet që ekzekutivi ta përpilon, ta formulon si duhet, do të njoftoheni edhe ju me mënyrën e formulimit kështu si biseduam. A pajtoheni që të miratohet ky propozim i drejtorit?

Konstatojmë se në mënyrë unanime anëtarët e Kuvendit miratuan Rialokimin e mjeteve kapitale.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi, kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës, Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Mirushe Sadikaj e ka kërkuar fjalën.

Mirushe Sadikaj, desha dy pyetje për drejtorët pasi që janë këtu, ndoshta dalin tri veç kisha pasur dëshirë me jap përgjigje menjëherë. Kam një pyetje nga kolegët mësimdhënësit lidhur me shujtat e mësimdhënësve se në disa Komuna është bërë

pagesa e tyre, e po kërkojmë përgjigje pse te ne jo, se dihet që mos pagesa ose vonimi i tyre veç i rrit shpenzimet e Komunës. Dhe shumë pyetje tjera që ka bërë kolegia nuk kemi pasur përgjigje, kemi pasur në atë kohë mirëpo më vonë nuk kemi pasur përgjigje çka do të bëhet si p.sh pagat jubilarë. Edhe një pyetje pata për drejtorin përkatës lidhur me asfaltimin e rrugës “Shaban Sadikaj” ka qenë e projektuar për këtë vit me u përfunduar ajo rrugë a do të fillojë, kur do të fillojë? Edhe një pyetje tjetër, kur kemi probleme me kanalizim, të cilat probleme kanë qenë që në fillim të montimit të gypave, ato shpenzime a duhet t’i mbulojnë vet qytetarët apo duhet të kërkohet nga Komuna, ose nga kompania përkatëse. Faleminderit kaq kisha!

Kryesuesi, drejtori i drejtorisë së Arsimit Hajrush Shoshi e ka fjalën.

Hajrush Shoshi, përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket kontratës kolektive, ky është një problem që për momentin është problematikë në krejt Komunitatet e Kosovës, mirëpo lëndët në Komunën e Istogut të gjitha janë në gjykatë, ku mesimdhënësit e kanë paditur Komunën, e tash ne edhe me i pasur mjetet nuk mundemi t’i realizojmë pa përfunduar procedura gjyqësore.

Kryesuesi, faleminderit Drejtor! Për rrugën ‘Shaban Sadikaj’ në Studenicë e bëri pyetjen. Ka qenë në projekt a do të realizohet këtë vit?

Enver Rugova, ajo më duket se është për vitin e ardhshëm rruga ‘Shaban Sadikaj’. Ashtu shikoje në listë të projekteve. Sa i përket kanalizimeve e nderuar unë si drejtor i Shërbimeve Publike kam asi lloj përvojave mjaft, ato ndodhin shumë shpesh, dhe pikërisht në ato kanalizime që nuk janë punuar me kohën bash mirë, kur të është faji i qytetarëve aty, që faktikisht për fajn e tyre bllokohet, aty bëhet një kosto se ka dëmtime normal që e paguajnë banorët, por kur të është defekti si kemi pasur në Dobrushë, kemi në Banjë që është faktikisht faji implementuesit atë defekt e marrim ne përsipër, tash e kemi kompaninë për mirëmbajtjen infrastrukturore dhe çdo defekt do ta rregullojmë shumë shpejt edhe në aspekt kualitativ.

Kryesuesi, faleminderit Drejtor! Labinot Aliaj është lajmëruar.

Labinot Aliaj, unë një pyetje e kam në lidhje me rrugën ‘Rexhë Destani’ projekt ky që ka stagnuar dhe nuk po vazhdon asfaltimi i saj. Edhe e kam një kërkesë për Kryetarin nga një grup i të rinjve që janë inxhinier të cilët pas vizitave që i kanë bërë palestrës, kanë konstatuar që klima komorja e vendosur prapa palestrës te dera

emergjente, të zhvendoset në pjesën e objektit lartë, ku flitet që ka qenë edhe e paraparë vendi për të d.m.th mos të pranohet puna ku është vendosur këtu për shkak të rrezikshmërisë që e ka ajo. D.m.th janë grup i djemve ekspertë, inxhinierë të cilët punojnë edhe për kompani jashtë Kosovës edhe të cilët e kanë paraparë si të rrezikshme. Po me vjen keq që nuk është edhe Arifi këtu por ish dashtë me u vendos kjo aty ku e ka vendin e paraparë lartë në palestër që të mos ketë kontakt askush me të, për shkak që munden me e dëmtuar këtë, edhe është rreziku i jetës i një të riu ose të reje që e frekuenton atë rrugë andej. Ky ishte një shqetësim i qytetarëve drejtuar Kryetarit.

Kryetari, nuk e kam parë atë.

Labinot Aliaj, unë e kam në fotografi, tash ta ofrojë.

Kryetari, jo po nuk e kam parë, edhe nuk kam asnjë lloj kërkesë edhe Arifi nuk e ka qit atë se kur e ka marrë Arifi ajo ka qenë e përfunduar, tjetër kompani ka qenë ajo. Drin, shikojeni këtë interesohuni duhet me e shikuar.

Kryesuesi, mirë atëherë Ajshe Metaj e ka kërkuar fjalën.

Ajshe Metaj, unë desha vetëm një pyetje, një pyetje me bërë meqë tash jemi në fillim të vitit shkollor, kisha kërkuar nga kolegët, është e rëndësishme me dëgjuar se krejt i kanë fëmijët, kishte me qenë mirë me mbajtur pak disiplinë. Unë e kam një pyetje për drejtorin e Arsimit, duke e marrë parasysh fillimin e vitit shkollor dhe vështirësitë që tash janë paraqitur sidomos në shkollën fillore 'Bajram Curri' ku kanë rezultuar 3 të infektuar me Covid-19, çfarë planesh ka, se unë mendojë që është e rëndësishme, duke marrë parasysh situatën që është krijuar me mësimdhënësit që janë infektuar në shkollën fillore 'Bajram Curri' kam pyetje për drejtorin e Arsimit çfarë planesh ka, se edhe një herë ja kam bërë një pyetje a ke listë të pritjes së mësimdhënësve pa Covid-19 fare, drejtori më është përgjigjur jo. D.m.th. duhet me e pasur një çelës në mënyrë që me vazhduar si me dalë prej situatës. Faleminderit!

Kryesuesi, drejtor urdhëro!

Hajrush Shoshi, përshëndetje edhe njëherë për të gjithë! Sa i përket situatës në shkollën e mesme të ulët 'Bajram Curri' në Istog deri më tani të konfirmuar i kemi 8 raste me Covid-19, të konfirmuara i kemi edhe 3 raste sot, jemi duke pritur komplet

rezultatet që na vijnë në orën 15:00, edhe e kemi caktuar me Kryetarin me e mbajtur një task force pasi të arrijnë rezultatet, sigurisht që me rezultate do të na arrijë edhe një rekomandim nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik. Edhe të dielën e kemi mbajtur task forcën po sa na kanë arritur rezultatet në nivel komunal, kemi marrë vendimet, kështu që gjasat shumë të afërta janë që të shkohet në mësim online për dy javë, mirëpo edhe Kryetari nuk është i pajtimit, do të provojmë me të gjitha mundësitë që ta vazhdojmë mësimin nëse na lejohet. Mund të ju sigurojë që kam kontaktuar para këtij takimi me të gjithë personat që janë të infektuar, dhe gjendja shëndetësore e tyre për momentin është stabile, edhe kjo është një shenjë e mirë, ose një lajm i mirë po them, prandaj ta shohim edhe pasi të vijnë edhe këto rezultatet tjera sigurisht që task forca do të dalë me një qëndrim të përbashkët me një vendim.

Kryesuesi, faleminderit drejtor! Ajshe Metaj dhe Besa Ferati janë lajmëruar

Ajshe Metaj, dua të ndërlihem pak këtu, faktikisht ata që kanë rezultuar dhe ata të pa konfirmuar janë në gjendje që brenda këtij afati që do të shërohen ta mbajnë mësimin qoftë edhe të variantit online.

Hajrush Shoshi, mësimin online ata e vazhdojnë.

Ajshe Metaj, d.m.th. janë në gjendje të mirë shëndetësore?

Hajrush Shoshi, janë në gjendje të mirë shëndetësore, veç kanë filluar ta mbajnë me tri klasë të cilat i kemi për momentin online, varësisht prej situatës edhe ne do të gjendemi. Mund të ju them se diku para tri ditësh ka ardhur edhe fondi prej 64 mijë eurosh që është dedikuar prej Ministrisë pikërisht për këto raste, për mësimin online, për pajisje për dezinfektim, për të gjitha këto rastet d.m.th do të punojmë aq sa mundemi.

Ajshe Metaj, janë masa të vonuara, se pasi ndodhë infektimi, sa do duhet me e parandaluar infektimin po nuk kemi çka të bëjmë janë këto që janë.

Hajrush Shoshi, unë besojë se nuk ka dalë ende dikush me e parandaluar infektimin, mund të ju sigurojë që përgatitjet në nivel shumë të duhur, ky është edhe një vlerësim prej inspektoratit regjional në Komunë të Pejës, por edhe prej inspektoratit të Komunës tonë, edhe prej organeve të tjera që kanë ardhur prej

Ministrie, përgatitjet kanë qenë të duhura, objektet janë përgatitur ashtu siç duhet, dezinfektues ka pasur mjaftueshëm, dorëza kanë, maska gjithashtu. Ne i kemi kryer obligimet tona.

Kryesuesi, faleminderit Drejtor! Besa Ferati e ka fjalën!

Besa Ferati, faleminderit Kryesues! Desha një pyetje të shkurtër, a janë testuar edhe nxënësit që kanë pasur kontakt me këta mësues, apo veç mësimdhënësit?

Hajrush Shoshi, jo vetëm mësimdhënësit janë testuar. D.m.th. dje është testuar edhe pjesa tjetër, e mësimdhënësve që kanë mbetur prej 55 mësimdhënësve, sot po priten rezultatet, deri para takimit na i kanë konfirmuar edhe dy raste të reja që janë. Kështu që në ora 15:00, do të kem rezultatin komplet. Sigurisht se pas kësaj vale instituti do ta testojë edhe ndonjë nxënës sigurt.

Zenel Shatri, sa për sqarim, rastet e kontaktit nuk testohen, vetëm shikohet nëse kanë simptoma. E dyta, as nuk ri testohen mësuesit pas 15 ditësh, se 15 ditë është afati, pas 15 ditësh i thërret Instituti i shëndetit publik edhe i lejojnë me punuar. Përndryshe nëse ata janë të sëmurë duhet të shtrihen në spital. Unë i kam vizituar një dy prej tyre gjendja është e mirë. Vetëm se nuk testohen rastet e kontaktit.

Kryesuesi, fjalën e ka Kryetari.

Kryetari, shiko pyetja e Ajshes ishte me vend, se nuk e kemi pritur se të ndodhë në shkollat tona, mirëpo të jeni të sigurt, po ju them kështu me bindje të plotë, çdo gjë ka filluar mirë në Istog. Jemi marr shumë me këtë punë, vet i kam inspektuar, unë e kam marrë lajmin i pari për këta 5 mësuesit e infektuar se mua më vjen direkt prej Institutit, i vjen edhe Doktorit që punon direkt atje në spital, kështu që jemi takuar të dielën edhe unë atë ditë vendosa, më ka ardhur vështirë se në bazë të rekomandimeve që kanë ardhur nga Ministria e Shëndetësisë aty kishte mundësi kjo task forca me e mbyllur shkollën komplet, d.m.th. ka pasur bazë, po goxha e dhimbshme me e mbyllur shkollën, kështu që pak një dozë rreziku e ka, pa bërë shkelje, po jepet mundësia që me vazhduar edhe në këtë formë. Kështu që ne menduam që ta provojmë deri sa të arrijnë rezultatet, se nëse kjo fillon aty neve na duhet me u detyruar me e mbyllur, nuk guxojmë të rrezikojmë se dikush pastaj e merr përgjegjësinë këtu, mirëpo asnjë veprim nuk jemi duke e bërë pa u marrë vesh me Institucionet Qendrore, duhet ta keni parasysh. Institutin Kombëtar, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit sidomos, ne jemi pajtuar me vizitën e Ministrit që me shumë korrektësi, me e filluar, krejt janë siguruar me pajisje me dezinfektues,

ndoshta nuk jemi shumë të përgatitur, nuk kemi llogaritur, definitivisht futet mësimi online në kuptimin e teknologjisë, por mund të ja dalim edhe asaj i kemi mjetet mirëpo procedurat pak po na vonojnë. Kemi telashe me procedura, në njërën anë na i kanë qit ndarë mjete me atë vendimin e fundit atje 100 mijë euro të Asimit, asnjëherë nuk na është dhënë mundësia që t'i bëjmë procedurat e përshpejtuara, në situata emergjente çfarë janë, kështu që jemi duke u marrë me këtë punë. Tash unë desha me jap një informacion aty nga një 10 milionësh që janë ndarë për Komunitet e Kosovës me një vendim që e ka marrë Qeveria rreth pandemisë, ne e kemi bërë një ndarje, që ka qenë kompetencë e ekskluzive e ekzekutivit, mundet Hysi si drejtor me treguar se ku e kemi dërguar edhe cila është arsyeja se pse kanë shkuar.

Agron Avdijaj, unë desha diçka që lidhet me buxhetin, arsimin, në nivel qendror diku 13 milionë është kufizuar buxheti prej nivelit qendror, nuk po di sa ka ndikuar kjo te Komuna e Istogut?

Kryetari, 13 milionë për Komuna?

Agron Avdijaj, jo ky dhjetëshi që është ndarë për rastet me Covid-19 po. Por buxheti për arsimin në nivel të përgjithshëm.

Hysni Maxharraj, e ka fjalën kur ka ardhur ajo shkresa për rishikim të Qarkores. Sa për informim për juve qytetarë të nderuar, na ka ardhur një shkresë me email prej Ministrisë së Pushtetit Lokal me datë 17.09.2020 edhe menjëherë na është kërkuar që në afat prej 24 orëve për me kthyer përgjigje se ku me i alokuar ato mjete që na kanë takuar neve si Komunë e Istogut në kuadër të këtij 10 milionëshit për ndihmë institucioneve komunale për Covid-19. Dhe ne kemi vendosur me Kryetarin që 100.000,00€ të alokohen në Arsim, 100.000,00€ në Shërbime Publike, 50.000,00€ në Shëndetësi, edhe 15.361,06€ në Zyrën e Kryetarit. Për në Arsim po dihet ka kërkesa të mëdha se ka duhet të shpenzohen, te Shërbimet Publike d.m.th shkojnë 35.000,00€ në subvencione për me i ndihmuar Ndërmarrjes Publike 'Stacioni i Autobusëve' dhe 65.000,00€ në mallra dhe shërbime, në kuadër të së cilës do të shpallë tenderë për dezinfektim dhe për blerje të ushqimit dhe materialit higjienik –sanitar sipas kërkesave dhe nevojave si paraqiten deri në fund të vitit. Po ashtu në Shëndetësi 30.000,00€ është kërkesa në subvencione dhe 20.000,00€ në mallra dhe shërbime në kuadër të ndihmës për Covid-19, dhe ne Zyre të Kryetarit 15.000,00€, kryesisht janë disa raste që kanë të bëjnë me kërkesa për raste shëndetësore që ka ndikuar drejtpërsëdrejti Covid-19 që me ju ndihmuar atyre rasteve. Pra kjo është një informatë se ku e kemi bërë kërkesën për alokimin e këtyre 265.000.00€ që nuk kemi pasur as mundësi e as kohë për me e thirr as mbledhjen e jashtëzakonshme për me ju informuar. Faleminderit!

Kryesuesi, faleminderit Drejtor! Dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Nuk është lajmëruar askush. Atëherë duke ju falënderuar për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë në këtë takim. E mbylli seancën e sotme.!

Mbledhja përfundoi me punë në orën 13:25.

Procesmbajtëse,
Flora Bujupaj



Kryesuesi i Kuvendit,
Z. Qaush Balaj

